




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e dhjetë (X) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 29.9.2014 me këtë:

REND PUNE

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit.
- 3 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 3.1 Draft Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2015
 - 3.2 Projekt propozimi i Buxhetit për vitin fiskal 2015 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2016-2017
 - 3.3 Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit 01.Nr.53125 të datës 11.11.2011
 - 3.4 Plani komunal për efikasitet të energjisë 2014-2020
 - 3.5 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013
 - 3.6 Propozim vendimin mbi qasjen e hartimin e Planit të hollësishëm rregullues; "Qendra-4" në Gjilan
 - 3.7 . Kërkesë për përkrahje financiare të Florie Mehmetit nga Gjilani për operim të syrit.
 - 3.8 Propozim vendimin për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për nevojat e rrugës publike –Shkolla e Zabelit
 - 3.9 Rekomandim për nxjerrjen e vendimit të ri për kriteret e regjistrimit e nxënësve në klasat e para
 - 3.10. Kërkesë për përkrahje financiare për tre student të cilët studiojnë jashtë Kosovës
- 4 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Në punimet e seancës së dhjetë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesi i OSB-së, Basri Sejdiu

Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, Shaban Terziu

Mediet

Seancën e dhjetë e hapi dhe e udhëhoqi kryesuesja e Kuvendit e cila i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, mediet dhe të gjithë të pranishmit e tjerë të cilët e monitorojnë punën e KK-së.

Fillimisht të konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Sekretaria konstatoi se në punimet e seancës së dhjetë ishin të pranishëm: 34 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi 1 (një); Selvete Shurdhani.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- para se ta aprovojmë rendin e punës, propozoj që pika 3.3 për ndryshim të Statutit të Komunës të shtyhet për një seancë tjetër, pra për një seancë të veçantë, sepse është çështje me shumë rëndësi. Unë propozoj që kjo pikë e rendit të punës të hiqet nga rendi i ditës, ju lutem të deklaroheni se kush është për këtë propozim?

Aprovohet propozimi i kryesueses që pika 3.3: Statuti për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjilanit 01.Nr.53125 të datës 11.11.2011 të hiqet nga rendi i punës, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 7 ishin kundër.

Aprovimi i procesverbalit

Nuk pati vërejtje në procesverbal dhe u miratua pa vërejtje

Bujar Nevzadi- sa i përket rendit të ditës ju e aprovuat që të hiqet pika 3.3. për ndryshim të statutit, por duhet të thuhet qartë se nuk i keni votat dhe kjo është arsyeja e parë dhe këtë po ia bëj të gjithëve me dije si anëtarëve të Kuvendit, mjeteve të informimit dhe tërë opinionit.

Në 2, propozoj që pika 3.9 nuk e ka vendin për debat në seancë, sepse ky propozim nuk është miratuar në Kuvend, por e ka miratuar Komiteti i Arsimit dhe Drejtoria e Arsimit dhe duhet të kthehet atje. Mirëpo në vend të pikës 3.3. ne kërkojmë një informatë nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor.

Nën të ndryshme kërkoj që të më epet fjala dhe kryetari të jetë prezent, sepse kemi nevojë t' i shprehim disa shqetësime tona e të cilat po na preokupojnë që 9 muaj.

Nëse kryetari qëndron deri në fund të seancës, unë ato shqetësime do t' i lë për pikën nën të ndryshme, nëse jo unë do t' i parashtoj disa pyetje dhe shqetësime tash!?

Arben Mehmeti- sa i përket heqjes së pikës 3.3, nuk është problemi i numrave, por problemi i numrave është te PDK-ja në nivel qendror dhe tek ne nuk ekziston ky problem. Mirëpo është problemi tek harmonizimi i qëndrimeve finale lidhur me organizmin e stafit organizativ të Komunës. Komisionit i duhet edhe njëherë të takohet, sepse i kemi dy variante të cilat duhet t' i harmonizojmë, kurse në një seancë të radhës do ta diskutojmë këtë çështje.

Sa i përket Arsimit, drejtori e ka dhënë një informatë në Komitetin e Arsimit, në të cilin komiteti kanë qenë edhe anëtarët e subjekteve tjera politike dhe si temë ne e kemi harxhuar në trupa të Kuvendit.

Sa i përket pikës 3.9 ne si Komiteti i Arsimit ne e kemi diskutuar këtë çështje dhe e kemi nxjerr një rekomandim me koncenzues të plotë dhe i kemi rekomanduar drejtorit të DKA-së që ta anulojë automatikisht vendimin e kaluar të ish drejtorit të Arsimit përkitazi me regjistrimin e nxënësve në klasën e parë. Arsyeja është për shkak të kërkesave të shumta dhe për shkak të interesit të prindërve dhe nxënësve. Për këtë arsyeje kemi rekomanduar që të bartet në KK kjo çështje, sepse regjistrimi i nxënësve është i një rëndësie të veçantë.

Bujar Nevzadi- unë do të jemi shumë i qartë dhe i saktë; 1. Nëse e keni harmonizuar këtë vendim, nuk keni pasur nevojë ta sillni në Kuvend!? Nuk i keni numrat sa i përket statutit, kjo qëndron! Nëse i keni numrat debatonë dhe le të hyjë në rend pune?

2. Kërkojmë informatë, komiteti ka kërkuar një informatë të shkurtër nga drejtori i Arsimit për mënyrën e fillimit të vitit të ri shkollor. Ka shumë ngjarje të cilat kanë ndodhur këto ditë, kur ju po tentoni për t' i fshehur, por nuk mund t' i mbulonë, sepse qytetarët i dinë gjërat.

3. Kriteret nuk kanë çka pse të anulohen, është sekretaria, shefi i Zyrës Ligjore dhe vendimet që nuk i ka marrë ky Kuvend nuk k nevojë të anulohen, ia keni rekomanduar drejtorit dhe drejtori e merr atë vendim dhe nuk kemi nevojë të humbim kohë.

Valenrtina Bunjaku- Rexhepi- drejtori i Arsimit në çdo mënyrë do të jep informatë në pikën nën të ndryshme, kure sa i përket numrave për çështje të statutit unë nuk e thash se është ky problem, por kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe do të jetë në një seancë të veçantë.

Arben Mehmeti- sa i përket statutit, anëtarët e Kuvendit edhe në material i keni dy variante, prandaj komisioni përfundimisht duhet ta sjell një variant, kurse Kuvendi është ai që vendos për këtë çështje. Sa i përket pikës 3.9, ne po dëshirojmë që t'ia rrisim rëndësinë fushës së Arsimit, sepse Kuvendi është organi më i lartë i cili merr vendime dhe mos të merr vendime si në të kaluarën nga një organ më i ngushtë e që më vonë janë shkaktuar probleme. Qëllimi është shumë i mirë dhe ai qëllim që mos të ketë probleme ligjore për ekzekutim të vendimeve. Ne i kemi rekomanduar drejtorit të Arsimit për ta anuluar vendimin, por edhe trupat e Kuvendit dhe Kuvendi duhet të dal me një vendim.

Bujar Nevzadi- unë kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit, Zyra Ligjore dhe kryetari i Komunës që të na e japin një përgjigje që një vendim që nuk e ka marrë ky Kuvend a ka nevojë ta shfuqizojë vendimin e organit tjetër?

Arben Mehmeti- në këtë rast është problemi që Kuvendi në të ardhmen, pas rekomandimit të Komitetit të Arsimit duhet ta merr një vendim të ri për regjistrim. Kurse çështjen e anulimit e kemi rekomanduar nga Komiteti i Arsimit, që drejtori ta anulojë dhe jo Kuvendi.

Riad Rashiti- unë sa i përket rendit të punës kam një propozim që të jetë një raport për vlerësim të vërsimeve me datë 31 korrik dhe mendoj se është jo serioze nëse nuk do ta kem një raport në këtë seancë për dëmet që janë bërë nga vërsimet në ekonomitë familjare dhe bujqësore. Ne e dimë se një komision i Komunës ka bërë një vlerësim të dëmeve në vlerë prej 1 milion e 600 mijë € e të cilin vlerësim ne e konsiderojmë si një vlerësim paushallë që është bërë, prandaj ne sot kemi pritur që sot ta kemi një raport më detal me të dhëna se sa është dëmi, i cilës natyrë është dëmi, në cilët sektor, emërtimet e tyre, listën e tyre. Ne po shohim që sot nuk ka ndodhur, prandaj kërkojmë që kjo sot të futet në rend të ditës, sepse një dëm kaq i madh që

është bërë dhe për të cilin është formuar Komisioni i Komunës, kurse në anën tjetër të mos kemi asnjë informatë për neve është e pakuptimtë.

Nën dy kërkojmë informatë nga Zyra e Prokurimit sa i përket kontratës përfituese me kompaninë për DDD-në, kërkojmë informatë se në çfarë vlere është nënshkruar ajo kontratë dhe çka ka ndodhur lidhur me procedurat për këtë rast, a ka ndërhyrë OSHP –ja dhe çfarë të gjeturash ka pasur me këtë tenderë? Cilat shkelje ligjore i ka gjetur OSHP-ja dhe kush ka ndërhyrë në këtë tenderë kërkojmë informatë të plotë.

Pastaj kërkojmë informatë nga Zyra e Prokurimit kontratën përfituese në vlerë prej 8 mijë € që ka ndodhur për aktivitetet e manifestimit kulturor “Ditët e mërgatës” e cila kontratë është nënshkruar një muaj pas realizimit të saj?

Në vazhdim i kam dy pyetje për kryetarin e Komunës, njëra ka të bëjë me pronat publike të cilat janë ngritur si shqetësim që të privatizohen nga AKP-ja, kërkojmë për ta ditur se a ka listë kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Komuna e Gjilanit për pronat e Komunës së Gjilanit të cilat nuk janë privatizuar ende dhe çfarë masa ka ndërmarrë që këto prona t’i mbrojë. Ne dimë se ka qenë në fuqi një vendim i KK-së i cili është nxjerrë në vitin 2010 e që kishte të bënte me parandalimin e privatizimit të pronave publike nga AKP-ja, kurse ju e propozuat që ta anuloni këtë vendim dhe e lejuat privatizimin e Çerdhes së Fëmijëve, kurse në anën tjetër dilni dhe akuzoni Qeverinë se po lejon privatizimin e pronave Komunale në Gjilan. Ne kërkojmë për ta ditur se cili është qëndrimi i juaj a jeni për ta mbrojtur pronën Komunale nga privatizimi, apo jeni për të lejuar që të shiten pronat Komunale e të cilat janë në interes të Komunës së Gjilanit. Duam ta dimë cili është qëndrimi i juaj, sepse keni dal me dy qëndrime të ndryshme brenda një kohe shumë të shkurtër. Edhe pyetja tjetër ka të bëjë me kryetarin e Komunës: “a keni dal ndonjëherë për ta vizituar Deponinë e Mbeturinave apo jo”? Ne jemi të informuar, se jeta për banorët afër asaj deponie Velekicë, Uglar dhe të lagjes “Arbëria” është bërë e padurueshme, kurse ju keni premtuar para fushatës elektorale se do ta mbyllni atë deponi.

Ju jo që nuk e keni mbyllur, por nuk jeni të interesuar aspak për përmirësim të gjendjes në atë deponi?!

Pyetjen e tretë e kam për drejtorin e Arsimit, një informatë të saktë se çka ka ndodhur me ekskursionin e organizuar me nxënësit e Shkollës së Mesme të Mjekësisë dhe Gjimnazit?

Sipas informatave ka pasur mosmarrëveshje në mes dy kompanive turistike njëra nga Gjilani dhe tjetra nga Prizreni, si pasojë e mosmarrëveshjes që keni pasur me përfaqësues që ne i themi të fuqishëm të kryetarit të Komunës, sepse kur ka filluar hyrja nëpër autobusë ka pasur shtyrje dhe ka pasur ndërhyrje të policisë dhe Prokurorisë.

Duam ta dimë saktësisht se çka ka ndodhur në këtë ekskursion.? Pse është zgjedhur kompania më e shtrenjtë, pse është zgjedhur kompania e jabanxhive në Gjilan dhe duam ta dimë se si ka rrjedhur procesi i ekskursionit deri në fund? Këto ishin pyetje për kryetarin e Komunës dhe për Zyrën e Prokurimit në Gjilan?

Valentina Bunjku- Rexhepi –zyrtarët e Zyrës së Prokurimit nuk janë këtu dhe besoj se kjo është më e rrugës që pyetjet që i përkasin kësaj zyre të adresohen me shkrim. Informatën për Arsim, drejtori qenka këtu dhe ai nën të ndryshme do të na informojë, por edhe kryetari qenka këtu dhe nën të ndryshme do të përgjigjet.

Riad Rashiti- sa i përket kërkesave të cilat i kemi bërë me shkrim, ju nuk po dëshironi, ose nuk po guxoni, apo nuk po i lexoni, sepse unë e kam potencuar në çdo seancë se i kam 44 kërkesa të cilat i kam bërë me shkrim dhe kam bërë pyetje të ndryshme, por nuk po marrë përgjigje! Kjo është mos transparencë e plotë të cilën e keni instaluar në KK të Gjilanit. Për të gjitha çështjet të cila ti ngrita këtu, paraprakisht kërkoj përgjigje me shkrim, pastaj të debatohen në seancë. Mirëpo nuk kemi marrë përgjigje asnjëherë dhe kjo është papërgjegjësi totale e juaja.

Shukrie Rapuca- unë e kam nga një pyetje për kryetarin dhe për drejtorin e Bujqësisë, sepse në tërë rajonin, por edhe në Komunën tonë është përhapur sëmurja e deleve e quajtur “Gjuha e kaltër” e cila është një sëmurje shumë e rrezikshme edhe për delet, por edhe për njerëzit. Kërkojmë një informatë nga drejtori i Bujqësisë edhe pse e dimë se përgjegjësi e kujt është, por edhe Komuna nuk është përgjegjësi në këtë rast.

Duhet të informoheni si është gjendja dhe çfarë masa ka marrë Drejtoria për ta parandaluar përhapjen e kësaj sëmurje. Për shkak të përhapjes ë kësaj sëmurje, qytetarët janë shumë të shqetësuar, sepse tash jemi në prag të festës së Kurban Bajramit.

Pyetja e dytë është për kryetarin e cila pyetje ka lidhshmëri me të parën dhe konkretisht pse nuk është bërë dezinfektimi i mushkonjave dhe çka mund të pritët prej kësaj gjendje, kur shumë qytetarë mendojnë se sëmurja paraprake është përhapur pikërisht për shkak të mos trajtimit të mushkonjave, kurse ne në qeveritë paraprake që nga viti 2008, për çdo vit e kemi bërë dezinfektimin për zhdukje të mushkonjave.

Fehmi Sylejmani- edhe ne kërkojmë një informatë nga drejtori i arsimit e posaçërisht lidhur me skandalin e fundit të ekskursioneve. Gjithashtu edhe një informatë nga u.d i DKRS-së, sepse ditëve të fundit kemi shuarje të klubeve i cili fakt po koïncidon me tentativën për shuarjen kësaj drejtorie. Me këtë rast i drejtohem kryetarit të Komisionit për ndryshim të statutit, se tentativa për t’ i shuar dy drejtori janë shumë të gabuara dhe nuk duhet të ndodh kjo!?

Arben Maliqi- unë mendoj se nuk ka nevojë që të parashtrohen pyetjet tash, por vetëm të paraqiten se kanë çështje për të shtruar për nën të ndryshme. Ju lus që të kemi një gjuhë më parlamentare dhe të jemi më të qetë. Nuk ka nevojë t’i jap leksione askujt, por konsideroj se nuk kemi nevojë as të bërtasim dhe të përdorim gjuhë të ashpër.

Unë i kam tri çështje për t’ i paraqitur nën të ndryshme, prandaj edhe për atë u lajmërova.

Sahit Abazi- një rast tejet eklatant ka qenë zonja kryesuese para disa muajve këtu, sepse pa kërkesë mësimdhënësve të Gjimnazit ia ke dhënë fjalën, kurse tash këtij axhës (Muharrem Bajrami) i cili i përfaqëson pensionistët nuk ia jep fjalën! Mësimdhënësit kanë ardhur në mënyrë të dhunshme në Kuvend dhe e kanë marrë fjalën, kurse tash ish arsimtarit tonë të nderuar nuk ia jepni fjalën!

Shpresa Kurteshi- iu përshëndes të gjithëve dhe po e paralajmëroj se unë kam çështje për të paraqitur nën të ndryshme.

Fatbardhë Selmani- unë deshta ta pyes kryetarin pse 10 punëtorë në QKMF të cilët janë në marrëdhënie pune me kontratë me Caritasin dhe Komunën e Gjilanit, por të cilët që disa muaj nuk kanë marrë paga. Pyetja është pse po ndodh kjo ? Pse këta 10 dhjetë punëtorë që disa muaj nuk marrin paga?

Lutfi Haziri- të nderuar zonja dhe zotëri, anëtarë të KK të Gjilanit dhe ju të tjerë prezent në këtë seancë jam i nderuar që para jush të paraqes të gjitha interesimet që lidhen me zhvillimet e Komunës sonë dhe në veçanti duke respektuar rendin e punës të miratuar nga ana e juaj. Administrata e Komunës së Gjilanit po mundohet për ta bërë punën e vetë në përputhje me ligjin duke zbatuar detyrat ditore dhe duke i zbatuar të gjitha vendimet e që kërkohet sipas detyrës ligjore.

Edhe kësaj here po më duhet ta them një çështje e të cilën z. Arben Mehmeti e tha para jush. Ky mandat dhe kjo Administratë është e interesuar që KK të jetë organi kryesor vendimmarrës në Komunën e Gjilanit dhe jo Zyra e Kryetarit dhe jo zyrat tjera si ka ndodhur më herët.

Ju jeni përfaqësuesit më të lartë të Komunës së Gjilanit dhe duke qenë anëtarë të Kuvendit me mandat politik ju përfaqësoni interesin komunitar në radhë të parë, interesin e grupeve të caktuara dhe në fund natyrisht edhe interesin e grupeve të juaja politike. Nuk jam i interesuar për ta ndryshuar rendin e punës në asnjë mënyrë nëse nuk ka këtu pyetje për kryetarin e Komunës. Për derisa në KK nuk ka të adresuara çështje specifike për rend të punës, unë do të vazhdoj të jem i durueshëm dhe t' i duroj ofendimet dhe ato shpeshherë edhe publike që bëhen për shkak të transmetimit, ofendimet përmes portaleve dhe insuatat që ngiten në emër të një kauze dhe në emër të një kërkesë. Jam i vendosur që aty ku është ligjit për të mos menduar shumë, por vetëm për ta zbatuar vetëm ashtu si është i shkruar. Mirëpo të dihet se unë përfaqësoj 60% të votës së qytetarëve dhe për këtë arsyeje sillem konformë të kësaj shumice të madhe.

Deri te rasti fundit te Sindikata e Pensionistëve që përfaqësohet nga Muharrem Bajrami e të cilin ne e njohim si mësuesin Mujë, veteran i madh i arsimit, kërkesat angazhimi i tyre, angazhimi edhe humanitar të shqyrtohet diskutohet dhe të flitet në Kuvend.

Këtë çështje duhet të mundohemi ta zgjidhim dhe unë e di problemin e pronave në mes dy shoqatave të pensionistëve, por derisa nuk e kemi përgatitur lëndën ne jemi të pafuqishëm për të bërë zgjidhje të problemit. Mirëpo nën të ndryshme edhe mësuesi Mujë mund ta thotë fjalën e vetë, por çështja e pronave duhet zgjidhur në mënyrë tjetër dhe jo me deklarata dhe me tendencë për ta shfrytëzuar dhe kapur momentin.

Të gjitha pyetjet që janë bërë nuk po e shoh se janë probleme për t' i zgjidhur si e tha z. Sylejmnai. Ne jemi të interesuar pse DKRS e ka këtë mënyrë, apo duhet përpjekur për ta gjet një rrugë tjetër në mënyrë që ta gjejmë një rrugë më të mirë për organizim të sektorëve.

Sot DKRS nuk janë drejtori! Janë drejtori në kuptimin formal në statut, por nuk janë funksional në kuptim të plotë. Në këtë aspekt ose duhet t' i bëjmë tri drejtori ose duhet ta gjejmë një mënyrë të organizmit për të qenë të pavarur. Sot ata aktualisht janë ata janë totalisht të varur nga subvencionet që i ndan Komuna. Duhet ta gjejmë mënyrën t' i pavarësojmë financiarisht dhe t' i ndajmë buxhet me kohë dhe të jetë drejtori më funksionale. Unë do të vijë në mbledhje të komitetit dhe në çdo mbledhje që më ftoni, por po më duket se ju ende nuk e keni kuptuar se nuk dëshiroj të kem ndikim në vendim- marrje dhe dëshiroj që lirshëm të punojë Kuvendi, kurse unë jam ai që i zbatoj vendimet e këtij Kuvendit. Si detyrë ligjore unë jam i ndarë, ligji ma ka ndarë funksionin, ligji m' i ka ndarë detyrat dhe nuk jam i obliguar në obligime ku ju keni për detyrë t' i realizoni.

Sa për informim nuk kemi marrëveshje me Caritasin, ajo marrëveshje është ndërprerë, është ndërprerë shumë herë me paralajmërim, është rishkruar marrëveshja, por nuk ka filluar të zbatohet për shkak të kostos buxhetore dhe mungesës së autoritet të Qeverisë së Republikës. Ne pas kësaj pike do ta miratojmë një buxhet dhe aty do të shihet së është një buxhet në bazë të Qeverisë dhe Kuvendit, por ne duhet të diskutojmë për diçka që është e lidhur me afat ligjor, sepse me 1 tetor duhet të paraqitet në organe. Të gjitha çështjet tjera t' i debatojmë nën të ndryshme, por iu lus për t' i zgjidh dhe jo për ta mund njëri tjetrin me fjalë. Kyerjabinxhia nuk ka ardhur më në Gjilan prej ditës që unë i kam fituar zgjedhjet si kryetar Komune, asnjëherë nuk ka qenë së paku zyrtarisht. Ai ka borxh këtij vendi dhe derisa nuk i kryen borxhet këtij vendi do të mbes i tillë. Për t' u bërë mik me Gjilanin dikush duhet ta pranojnë ashtu si është gjendja. Pranoni ashtu si është gjendja dhe kur të shlyhen borxhet, Gjilani i pranon miqtë e vetë, nuk i dallon dhe i përqafton dhe kjo neve na bën të dallueshëm në këtë segment. Unë nuk dua të hyjë në një monolog, sepse nuk dua të rrëshqas Kuvendi në një monolog politik.

Në Kuvend forma dhe mënyra ligjore është e rregulluar dhe nuk kemi nevojë t' ik askush dhe unë jam i gatshëm për të qëndruar për aq sa vlerësoj, por në momentin që nuk kam nuk e kam ndërmend të vijë këtu të shtyhem me fjalë dhe të prodhohen më shumë fjalë se sa punë.

Izmi Zeka- është e qartë se KK i dinë përgjegjësitë e veta, por i dinë edhe kryetari i Komunës. Unë mendoj se nuk kemi nevojë në t' i mbajmë ligjëratë njëri tjetrit, sepse e kemi një përvojë dhe një shkollë politike. Megjithatë duhet pasur konsideratë edhe për opozitën ashtu si kemi pasur në më parë. Unë po e them shumë qartë Hashim Thaçi është kryeministër i Republikës së Kosovës, kurse Gjilani është territor i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi nuk është jabanxhi në Kosovë! Kjo duhet të dihet dhe sot është kryeministër i Republikës së Kosovës dhe në këto momente kur ne po flasim. Mirëpo edhe nesër nëse nuk ndodh kjo formulë, ai do të jetë qytetar i Kosovës. Nuk duhet harruar sidomos z. Haziri se Hashim Thaçi as nuk është krye jabanxhi as jabanxhi, por është qytetar i Republikës së Kosovës dhe është njeri i cili e udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës. Unë nuk do të kisha dëshiruar të dëgjoj këso fjalori, sidomos prej një kryetari i cili ka një përvojë politike të gjatë. Në të gjithë komunikojmë kemi raporte të mira shoqërore dhe kolegjiale kur jemi jashtë institucionit edhe në Prishtinë po, kur këtu thuhet krye jabanxhi. Ai krye jabanxhi ka investuar në Komunë e Gjilanit nëse unë nuk gaboj janë diku 90 milion € investime. Unë nuk do të merrem ma atë se çka foli z. Haziri, por është mirë që edhe z. Haziri si kryetar i Gjilanit që ne e mbështesim në projektet e tij, por le të tregojnë se çfarë ka bërë ai? Është mirë të na tregoj z. Haziri se çka ka bërë deri më tash? Mua më duket absurd për një informatë të arsimit të hapim debat këtu, tash ka filluar mësimi dhe informata për fillim të vitit shkollor duhet të jetë.

Do ta lus kryetarin e Komunës që së pari të jetë më transparent, e dyta të mos merret me Prishtinën, sepse me Prishtinën ka kush merret, sepse ky është kryetar i Komunës së Gjilanit dhe nuk është i nivelit qendror. Z. Haziri ka thënë fjalë të mëdha, kurse unë tash po i pres rezultatet dhe besoni se unë do të kënaqem me rezultate të Lutfi Hazirit, por jo vetëm me fjalë. Ju falënderoj të keni konsideratë, Hashim Thaçi edhe kur unë po flas është kryeministër dhe besoj fuqishëm se do të mbetet edhe në të ardhmen.

Nuk pati debatues të tjerë për çështje të rendit të punës dhe kryesuesja kërkon që të aprovohet ky rend i punës?

Aprovohet rendi i punës me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

2. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit

Para anëtarëve të Kuvendit, e jep betimin Krenare Latifi-Kçiku, nga grupi kuvendar i LVV, sepse Besë Baftiu nga ky grup është zgjedhur deputete e Kuvendit të Kosovës.

3. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

3.1. Draft Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2015

Ilmi Limani— edhe pse është formuar komisioni nga ana e kryetarit i cili komision ka punuar shumë dhe i cili komision ka qenë i përbërë prej 7 anëtarëve. Sipas ligjit ky komision ka qenë i përbërë nga profile të ndryshme si ekonomistë, inxhinier, gjeodet dhe lëmive të tjera. Mirëpo ajo që është me rëndësi për vitin 2015 parashihet të ketë një zbritje e bazës tatimore, jo koeficienti, por zbritja! Zbritje do të ketë te prona 13.36%, te prona komerciale 7.78%, te pronat industriale 6.98%, te pronat bujqësore 6.21%, zonat e pakontrolluara 15.22%, institucionet shkollore private 7.78%. Këto zbritje do të mbulohen nga regjistrime e reja, kurse vlera monetare nuk vihet në dyshim. Këtë e kam punuar për analizë dhe banesat në zonën e parë kanë qenë 550 €, kurse me ndryshim do të jenë 470 €.

Ne këtë material e keni çdo shifër të cilën e ka bërë komisioni dhe janë zbatuar të gjitha ligjet që janë në fuqi dhe me të gjitha metodat si me metodë të anketimit dhe të tjera për t' i caktuar këto shifra.

Zijadin Maliqi- grupi i anëtarëve të LDK-së e përkrah këtë rregullore, sepse është e pranueshme, sepse nga rritja e normës tatimore që është bërë nga 008% në 0.15%, e dinë ata që kanë qenë anëtarë të Kuvendit më parë se atë nuk mund ne ta ndërrojmë, sepse nuk është e drejtë e Komunës për ta ndryshuar normën tatimore, sepse kjo është e drejtë e nivelit Qendror, por kemi mundësi për ta zvogëluar bazën tatimore. Baza tatimore është zvogëluar dhe sado pak, por mua ma merr mendja se do të bëhet një vlerësim krejt tjetër i cili vlerësim do të bëhet në bazë të vjetërsisë së objekteve dhe sipas materialit ndërtimor dhe do të jetë një vlerësim shumë më i saktë. Unë propozoj që këtë ta aprovojmë, unanimisht, sepse ne nuk mund të bëjmë ndryshime të tjera. pra si grup i anëtarëve të LDK-së e përkrahim këtë rregullore, sepse është në interes të qytetarë të Komunës së Gjilanit.

Nevzad Isufi- kjo është një rregullore për të cilën duhet të flitet dhe të gjithë dëshirojmë që ta kemi një rregullore sa më të përshtatshme për të gjithë qytetarët. Mirëpo në këtë rast dua ta bëj një propozim duke u bazuar në ligjin nr. 4/ 054 për kategoritë e Dala nga Lufta dhe neni 6 flet për lehtësime të qarta dhe parasheh lirimin e tatimit në pronë për Familjet e Dëshmorëve, Familje të Invalidëve të UÇK-së, të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve civil të luftës, viktimave civile të luftës e të cilat janë në gjendje të rëndë ekonomike, por edhe viktimat e dhunës seksuale. Kërkojmë pra që kjo kategori e cila është e bazuar në ligjin e përmendur të lirohen nga tatimi në pronë. Kjo parashihet në bazë të beneficioneve që i parashihet ligji. Propozoj pra që këto kategori të cilat përfshihen në ligjin e përmendur të lirohen nga tatimi në pronë.

Riad Rashiti- në emër të grupit të PDK-së do t' i japim disa vërejtje për këtë draft rregullore. Fillimisht duhet të themi se kjo draft rregullore për tatimin në pronë për vitin 2015 është e bazuar në ligjin e Republikës së Kosovës 03/ 204 dhe në Udhëzimin administrativ 5 të vitit 2011. Mirëpo askund nuk shihet që është marrë parasysh për bazë Udhëzimi tjetër i cili është shumë i rëndësishëm ai nr. 04 i vitit 2011. Ky ligj ka të bëjë drejtpërdrejt me përcaktimin e pronës së paluajtshme dhe standardeve të vlerësimit.

Në bazë të kësaj rregullore shihet se premtimet e dhëna për ulje të tatimit në pronë nuk kanë mund të bëhen duke ulur normën e bazës tatimore. Është tentuar një kohë të gjatë që të ulet baza tatimore, por kjo nuk ka ndodhur, por është ulur vlera tatimore e që ne e konsiderojmë se është bërë shkelje tjetër ligjore e kësaj qeverisje, sepse nuk e ka respektuar drejt dhe saktë ligjin nr. 3 / L -204 dhe nuk i ka respektuar dhe nuk i ka marrë parasysh absolutisht udhëzimin administrativ 04 të vitit 2011. Kjo praktik e qeverisjes komunale po vazhdon me shkelje të vazhdueshme të ligjit të Republikës së Kosovës dhe udhëzimeve tjera administrative.

Sipas kësaj rregulloreje po e potencoj se është bërë ulja e bazës tatimore të pronat e paluajtshme, por askund nuk është theksuar se nga cili komision. Është emëruar një komision, por kush është kryetari i komisionit, pse ai nuk ka ardhur sot t' i prezantojë vlerësimet që i ka pasur, sepse është një punë shumë e madhe, është një vlerësim i tërë pronave që është bërë, por nuk dihet përbërja e komisionit, cilën metodë e ka përdor ky komision për ta vlerësuar pronën, sepse janë tri metoda për vlerësim dhe ne nuk e dimë cilën metodë e ka përdor? Nëse i vlerësojmë mirë këtu shihet se është bërë jashtëzakonisht një ulje e madhe e vlerës reale të objekteve dhe pronës komunale. Këtë e potencoj edhe përfaqësuesi i LDK-së e që tha më vonë do të vijmë në një vlerësim real.

Me këtë fjali po shihet se nuk është bërë një vlerësim real i pronës publike dhe kjo le të kuptohet se në të ardhmen të bëhet një vlerësim tjetër. Ka qenë deshtë të theksohen të metat që janë bërë në këtë draft. Ulja e çmimit për metër katror për banesa dhe shtëpi në zonën e parë të qytetit nga 550 € në metër katror sa ka qenë, kurse tash është ulur në 470 € dhe për një

shtëpi për 500 € për metër katror sa ka qenë dhe tash 425 € nuk është bërë vlerësim sipas çmimit të tregut. Ky është vlerësim jo real, politik ose paushall sido që ta quajmë. Të ulët vlera brenda një viti e metrit katror në qytet mendoje nuk është reale absolutisht. Është mirë të na tregojë edhe drejtori i Buxhetit dhe Financave, por edhe kryetari i Komisionit të cilin nuk po e dimë se kush është, por të na tregojë se ku mund ta blejë një shtëpi me 425 € metri katror, të na tregojë? Kjo është një devalvim i vlerës së pronës, por nëse vazhdoni me këtë qasje të qeverisjes mund t' i bie vlera dhe mund të bie çmimi në këtë nivel. Ne mendojmë se me këtë ulje të çmimit të metrit katror ka synim që kur të shiten pronat komunale siç janë banesat e krijuara nga PPP të jetë njëfarë baze që në të ardhmen të shiten banesat me këtë çmim. Prandaj konstatojmë se në këtë rregullore janë bërë ndryshime të jashtëligjshme të uljes e bazë tatime të pronat e paluajtshme. Vitin e kaluar ne qeverisja e kaluar e kemi bërë një vlerësim ligjor, një vlerësim ligjor, një bashkëpunim me MEF-in duke i respektuar të gjitha standardet unike të vlerësimit të tregut. Mirëpo ne e kemi tash një propozim tjetër si grup i PDK-së dhe kemi kërkuar që të bëhet ndarja në zona në bazë të cilave vlerësohet edhe prona e paluajtshme. Në zonën, katër dhe pesë sipas jush nuk janë reale dhe të drejta vlerësimet, p.sh. banorët e fshatit Malishevë e Epërme e që është vetëm pesë kam larg nga qyteti është në zonën e pestë, kurse fshatrat Nasalë, Haxhaj, Demiraj janë trajtuar si zonë e katërtë edhe pse janë dy herë më larg se Malisheva e Epërme. Sipas kësaj logjike të ndarja e zonave kryefamiljarët do të paguajnë më shumë tatim, sepse dallimi i vlerësimit për metër katror në shtëpitë e tyre është 75 €. Nëse një kryefamiljar në Malishevën e Epërme e ka një shtëpi 200 metra katror do të paguaj tatim në pronë 33 € në vit, ndërsa kryefamiljari në fshatin Haxhaj, Nasalë dhe Demiraj me të njëjtën shtëpi me të njëjtën sipërfaqe do të paguajë 55 € edhe pse është dy herë më larg nga qyteti në krahasim me Malishevën e Epërme. Kjo është e papranueshme për banorët e këtyre fshatrave, prandaj propozojmë që këto fshatra të përfshihen në zonën e pestë.

Ne si grup i PDK-së kërkojmë që të gjenden mundësitë ligjore për të stabilizuar tatimin në pronë ashtu siç e kemi bërë gjatë qeverisjes sonë. Për pesë vite me radhë e kemi ulur tatimin në pronë të paluajtshme për qytetarët e Gjilanit. Po ashtu i kemi ulur edhe të gjitha taksat komunale, kurse për bizneset i kemi ulur taksat, por në fund të qeverisjes i kemi hequr në tërësi ato. Prandaj ne i kemi respektuar ligjet e Republikës së Kosovës i kemi respektuar rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtar për të mbështetur bizneset e Gjilanit. Mirëpo ju keni propozuar një draft rregullore duke e shkelur ligjin dhe Udhëzimin administrativ.

Arben Mehmeti- unë me një pjesë të madhe të vërejtjeve të Riadit nuk pajtohem absolutisht, por pajtohem që Malisheva e Epërme duhet të jetë në zonën e katërt, por edhe Vërbica e Kmetocit. Sa i përket çështjeve tjera, tatimit në pronë ne jemi dëshmitar të vendimeve të rënda të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe atë prej ministrit në detyrë, sepse e ka goditur jashtëzakonisht shumë shtresën e qytetarëve të Republikës së Kosovës me tatimin në pronë. Edhe jam shumë i sigurt se sikur të kishte pasur ndonjë ligj i cili do të lejonte diskriminime, tatimi në pronë në Gjilan do të ishte 0.50% dhe jo 00.15%. Dihet shumë mirë se Gjilani ka qenë i diskriminuar që 5 vite pikërisht nga kjo qeverisje dhe të gjitha të mirat çka i kemi me rritje të tatimit në pronë 100% dhe shumë dëme të tjera që na u kanë bërë. Nuk janë lejuar diskriminimet me ligj, sepse po të lejohej një diskriminim i tillë Gjilani do të ishte 0.50%, kurse Drenica 0.10%

Arben Maliqi- këtë që e tha parafolësi është e vërtetë dhe duhet të jemi të vetëdijshëm se qytetarët e Komunës së Gjilanit më së tepërmi janë ankuar dhe kanë qenë shumë të pakënaqur me tatimet në pronë. Mirëpo unë mendoj se kjo draft rregullore e tatimit në pronë është një sihariq i mirë për të gjithë qytetarët e Gjilanit. Mirëpo mua çka më intereson është se ka edhe qytetarë të cilët kanë qenë shumë të ndërgjegjshëm të cilët tatimin në pronë e kanë paguar më herët dhe nuk kanë pritur për ta paguar në dy rata, por e kanë paguar menjëherë, prandaj kam

pyetje se a do të vlejë kjo draft rregullore për ata qytetarë ajo zbritje në tatimin në pronë? Unë e përshëndes këtë draft rregullore dhe besoj se të gjithë do ta mirëpresim.

Avdyl Aliu- në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së i urojmë punë të mbarë koleges sonë të re, por kam edhe mirënjohje për komisionin i cili ka arritur për ta bërë këtë punë lidhur me tatimin në pronë. Kjo është një punë e cila ka qenë desh të kryhet më herë, por sot na ra hise neve për ta bërë këtë draft. Mirëpo si profesionist që merrem me ndërtim, vlera 470 €, për banesa dhe 425 për shtëpi, kjo vlerë është vetëm e objektit për pa u llogaritur edhe toka. Shuma 425 € është shumë reale, por edhe për banim 470 € është shumë reale dhe shumë transparente. Ajo që do të ishte punë e mirë e jona sot këtu është që të kërkojmë nga qytetarët që t' i shlyejnë borxhet, sepse për mos pagesë të tatimit në pronë, qytetarët penalizohen dhe ndëshkohen me kamata marramendëse e të cilat janë të përcaktuara nga niveli qendror, por edhe borxhi nuk pret ditë të mirë.

Bujar Nevzadi- e lus edhe njëherë po iu lus që mos u merrni me qendrën të cilën gjë e tha edhe zv/ministri Izmi Zeka, por merruni me punët e juaja të nivelit lokal. Kaluan 10 muaj dhe ju jeni duke u marrë me qendrën. Merruni ju me punët e juaja që i keni këtu.

2. Gjilani e ka pasur normën më të ulët në Kosovë deri në vitin 2012, prandaj shtrohet pyetja kush e ka ulur atë normë? Mirëpo unë e kam edhe një pyetje për kryetarin e Komunës i cili gjatë fushatës ka deklaruar se do ta bëjmë zvogëlimin e normës tatimore, prandaj po pyes pse nuk e bëni zvogëlimin normës tatimore, por e bëni zvogëlimin e bazës tatimore? Nuk keni të drejtë ligjore, prandaj mos u merreni me qeverisje qendrore, sepse ka përfunduar fushata dhe tash filloni ju dhe tregoni se çka jeni duke bërë? E keni mashtruar publikun

Mandej kam pyetje për drejtorin e Financave, sa është faturimi për vitin 2014 dhe sa është obligimi i qytetarëve në tatimin në pronë, por kjo pyetje vlen edhe bizneset?

Selami Xhemajli – në emër të grupit të anëtarëve të AAK-së e përkrahim këtë draft rregullore të tatimit në pronë, sepse duke pasur parasysh qëllimin e kësaj rregulloreje e cila siguron të hyra vetanake për buxhetin e Komunës, por duke i marrë për bazë edhe sqarimet që i dha edhe drejtori që të bëhet zbritja e bazës tatimore në vlerë prej 10% do të jetë një vlerësimi dukshëm për qytetarët. Kjo zbritje do ta rrit numrin e atyre që i përgjigjen pagesës me kohë të obligimeve të tyre ndaj. Komunës në tatimin në pronë me të cilat pagesa do të arrihet niveli i kënaqshëm në buxhetin e Komunës. Aty ku ka qenë e pamundur norma tatimore të zvogëlohet për shkak të nivelimit të nivelit qendror dhe si komisioni dhe si KK mendoj se kemi obligim që ta përkrahim zvogëlimin e bazës tatimore, sepse kjo zbritje është në dobi të qytetarëve. Unë në emër të grupit të AAK-së i jap përkrahje të plotë kësaj rregulloreje të tatimit në pronë.

Zijadin Maliqi- unë jam shumë i bindur se nuk ka shkelje ligjore në qoftë se kemi bërë një zvogëlim të bazës tatimore dhe jo të normës tatimore. Kryetari as në fushatë dhe asnjëherë tjetër nuk e ka thënë se dot a bëjmë zvogëlimin e normës tatimore. Këtë e dinë edhe kryetari, por e dimë edhe ne se normën tatimore e cakton dikush tjetër. Vlerat që janë deri më tash janë bukur një kohë të gjatë, por tash ka ndryshuar realiteti për këto tatime. Unë përsëri po e them nuk është vlerësim real, por as që ka qenë vlerësim real i objekteve. Vlerësim real është ai vlerësim kur bëhet nga ana e komisionit shtëpi për shtëpi dhe caktohet çmimi në bazë të vendit, në bazë të materialit të ndërtimit dhe në bazë të vjetërsisë së objektit, por ajo ende nuk ka ardhur në radhë dhe atë nuk mund ne ta bëjmë si Gjilan. Ajo bëhet në nivel të Kosovës dhe besoj se shumë shpejtë do të veprohet dhe atëherë është vlerësim real. Mirëpo ky është një lehtësim bukur i mirë për qytetarët e Komunës sonë dhe për këtë arsyeje mendoj se duhet ta përkrahim të gjithë.

Nevzad Isufi- unë kam një pyetje lidhur me tatimin pasi që tatimi ndahet në dy- tri pjesë, atëherë pse nuk bëhet për stimulim nëse bëhet penalizmi kur e paguan pas afatit, pse nuk bëhet stimulimi kur e bën pagesën para afatit? Kjo është stimuluese dhe për qytetarët, sepse përpos që i kryejnë obligimet e veta, njëkohësisht ndikojnë në realizim të buxhetit një kohë më të shpejtë. Mandej ne e dimë se objektet e banimit amortizohen, prandaj kam pyetje sa është shkalla e amortizimit për vit a llogaritet kjo për çdo vit apo llogaritet sa herë ta ndryshojmë këtë rregullore të tatimit në pronë?

Riad Rashiti- sa i përket ndarjes në zona që e kemi bërë ne në qeverisjen e kaluar, është mirë që ju ta bëni, sepse e keni thënë se do ta kemi një qeverisje ndryshe. Ne për çdo vit kemi bërë ndryshime dhe këto ndryshime janë edhe vlerësime të institucioneve ndërkombëtare të cilat gjenden në Gjilan duke përfshirë edhe USAID-in Amerikan.

Në bazë të USAID-it është bërë rekomandimi për ta rrit bazën e normës tatimore. Nuk ka qenë mendim i qeverisë si po thotë kolegu i LDK-së për dëshirë të ndonjë ministri apo kryeministrit. Kjo rritje e normës tatimore është bërë me rekomandim të USAID-it i cili e ka rekomanduar për t' u rritur vlera e buxhetit Komunal të Gjilanit. Nuk është e vërtetë se i intereson një ministri apo kryeministri ta ngarkojë qytetarin e Gjilanit me normën tatimore 0.50%. të gjitha të hyrat që bëhen nga tatimi në pronë mbesin në Komunën e Gjilanit dhe asnjë € në Qeverinë e Kosovës. Për këtë arsyeje është mirë të informohemi për të hyrat ku shkojnë dhe ku shpenzohen? Më vjen mirë që edhe për të dytën herë u potencua se nuk është vlerësim real të cilin vlerësim e thanë edhe dy anëtarë të Kuvendit të LDK-së , mirëpo shefi i grupit e tha që është vlerësim real, nëse është vlerësim real unë e pyes shefin e LDK-së me çfarë çmimi i ka shitur mijëra katror të banesave në Komunë të Gjilanit? Nëse i ka shitur nga 470 €, unë kërkoj falje dhe i them ok, por unë nuk e di që ky ka shitur banesa nga 470€ metrin katror. Ndërsa për atë a është shkelur ligji apo, jo unë i lexoj dy nene: u lexua Ligji nr. 3 /L - 204 për tatimin në pronë e paluajtshme,

Ne e thamë se është shkelje ligjore, sepse nuk po respektohet ky ligj dhe Udhëzimi administrativ 4/2011. rregullorja në asnjë vend nuk është thirrur në këtë ligj dhe udhëzim administrativ.

Ilmi Limani- z. Isufi pyeti për veteranët e luftës, por edhe ne kemi dëshirë që veteranët e luftës t' i lirojmë, por ligji nuk lejon që të lirohen veteranët nga tatimi në pronë për pa u aprovuar në Kuvendin e Kosovës. Sa i përket penalizmit ne si asociacioni komunave kemi kërkuar që të hiqet ose kamata ose ndëshkimi prej 10%, sepse këto ndëshkime janë të larta, por kjo nuk varet prej neve. Sa i përket vlerësimit të shtëpive në të ardhmen do të bëhen tri kategori të shtëpive të dobëta, të mira dhe shumë të mira. Sipas tatimit në pronë ende nuk e kemi të lejuar amortizimin. Sa i përket pyetjes së Riadit unë e thash se janë marrë të gjitha metodat, sepse ekzistojnë shtatë metoda dhe në vend të çmimit të ndërtimit është zbrit vlera. Sa i përket zonave, ato i ka përcaktuar ish Kuvendi i Komunës në vitin 2007 apo 2008 dhe ka mbetur ende. Sa i përket Komisionit, ai ka qenë prej 7 anëtarëve dhe të gjithë janë të profileve të ndryshme dhe partive të ndryshme. Kjo draft rregullore vlen për vitin 2015 dhe nuk ka kthim prapa! Bujar Nevzadi pyeti për faturimet dhe borxhet, por në këtë seancë nuk mund të përgjigjem , por do të kërkoj nga shërbimi financiar që këto të dhëna të bëhen me shkrim.

Lufti Haziri- sa i përket kësaj pike të rendit të punës është një nga detyrat të cilën e kemi përgatit për ta realizuar e cila është para jush dhe shpresoj shumë që do ta votoni, sepse është në interes të qytetarit tonë dhe interes të buxhetit. Janë harmonizuar interesat, por në asnjë vend nuk ka Komunë të pasur duke i varfëruar qytetarët. Ne e kemi parë grumbullimin e

borxheve për vitet e kaluara dhe është një borxh aq i lartë sa që qytetarët nuk kanë mundësi për ta bërë pagesën. Ne e kemi zbatuar metodën tonë, formulën e cila ka nxjerr ulje të bazës dhe do të punojmë me Qeveri cilado që të jetë në të ardhmen për ta ulur edhe vlerën në kuadër të reformës së politikës fiskale. Mirëpo në hapin e parë ne e kemi bërë hapin e parë e kemi shfrytëzuar të drejtën tonë duke e bërë vlerësimin.

Cili ka qenë përfundimi i kësaj? Përfundimi i saj ka qenë që në shumë vlerësime duke u thirrur në ato udhëzime administrative të cilat z. Rashiti i përmendi, Komisioni e ka bërë vlerësimin dhe bazën e tatimit. Nëse një agjension kosovar e ka blerë një aset me 500 mijë €, e ka bërë pagesën e ka bërë nënshkrimin e kontratës dhe i njëjti komision komunal e ka vlerësuar atë 5 milion €. Cili është vlerësim i tregut, a është vlerësim i tregut sipas asaj që Qeveria e ka shit asetin 500 mijë €, apo është vlerësim i tregut që pas tre muajve komisioni e ka bërë kontratën 5 milion €. Duhet ta gjejmë gjithmonë interesin e përbashkët për të mos e dëmtuar as qytetarin qoftë ajo ekonomi familjare, apo veprimtari biznesore. Vendimi i ish kryetarit do të shqyrtohet për të gjitha kategoritë i cili ka qenë që nëse paguhet 50% të vlerës së tatimit do t' i lejohet shfrytëzimi i të drejtave në Gjilan. Ne jemi të interesuar për ta ulur në mënyrë që qytetari ta bëjë pagesën për pa pasur triesni nga Komuna. Çdo vit fiskal do të ketë ulje dhe vazhdimisht do të punojmë me organe qendrore që ta ulim edhe normën, sepse është e pamundur që kjo kategori të përballohet kjo normë që është sot. Rritja ka qenë 100%, kjo ka ndodhur brenda një viti buxhetor dhe për qytetarë ka qenë jashtëzakonisht e madhe.

Qytetari i Gjilanit deri këtë vit ka paguar dy herë më shumë se sa qytetari i Pejës, por nuk do t' i përmendi komunat e tjera. pse qytetari i Gjilanit ka qenë desh edhe në pronë edhe në taksa komunale të paguajë njëherë më shumë se qytetari i Pejës. A jemi ne më të pasur apo janë shtëpitë tona me standarde më të larta të ndërtimit me siguri jo!

Sidoqoftë ne po mundohemi për ta vendos një barazi duke e ulur vlerën, duke ulur bazën dhe duke bërë veprime konkrete dhe duke u koordinuar me qeverinë dhe drejtorinë përkatëse për ta bërë një vlerë të pranueshme për qytetarët. Kemi pasur fatin e keq që i janë shkaktuar Komunës 9 milion € borxhe, por nuk e kam ndërmend asnjë masë tjetër ta marrë pos t' i bëj lutje për ta bërë pagesën. Duhet bërë pagesën, sepse është obligim qytetarë, kurse obligimi i borxheve është politikë të cilën e kemi ndarë. Mirëpo kjo është lehtësi që po i ofrohet. Sa i përket familjeve të Dëshmorëve ne e kemi koordinuar punën dhe e kemi pasur rastrin dhe i kemi liruar dhe do t' i lejojmë edhe kategoritë e tjera sipas asaj që z. Isufi e përmendi, sepse jemi të interesuar për të vendos barazi., sepse një kategori e caktuar lirohet e cila nuk ka mundësi për të bërë pagesë duhet të lirohet.

Nuk pati debatues të tjerë për këtë pikë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që ta aprovojnë pikën 3.1 të rendit të punës.

Aprovohet pika 3.1. e rendit të punës: Draft Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2015, me 25 vota të anëtarëve të Kuvendit me vërejtjet që u dhanë, kurset të tjerët nuk u deklaruan për asnjë variant të votimit.

3.2 Projekt propozimi i Buxhetit për vitin fiskal 2015 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2016-2017

Ilmi Limani – ne më parë e kemi aprovuar kornizën afatmesme buxhetore në muajin qershor, por në kornizë në bazë “Qarkores 1” ku kanë qenë 10 milion rezervë dhe nga kjo rezervë Komuna e Gjilanit ka kërkuar një shumë prej 4 milion me qëllim që të zgjidhet problemi i

arsimit në shumë prej mbi 4 milion e 331 mijë €. Mirëpo MEF-i nuk na e ka aprovuar atë kërkesë dhe na e ka aprovuar me qarkoren e dytë të buxhetit prej 21 milion, 879 mijë €. Nga granditë e përgjithshme kemi mbi 17 milion, nga të hyrat vetanake 3 milion e 853 mijë €. Është e njohur se në Kosovë buxheti planifikohet prej së larti ulët dhe prej së ulëti lartë. Prej së ulëti janë kërkesat tona të cilat janë mjaft të rëndësishme, por edhe prej së larti kufijtë buxhetor dhe formohet komisioni i granteve prej 9 anëtarëve, kryeministri është kryetarë, 3 ministra anëtarë, 4 kryetarë të komunave dhe kryetari i komisionit për Buxhet dhe financa për buxhet të Kuvendit Kosovës. Në bazë të kësaj ky komision për komunën tonë dhe për komunat tjera kanë ndarë grante dhe granditë e përgjithshme është 10% e që mendoj se është një grand shumë, shumë i vogël.

Problem tjetër për Komunën e Gjilanit është granditë e arsimit, sepse është shumë i vogël, sepse në muajin mars janë ngjirë pagat për 25%. Granditë e arsimit për vitin 2015 është diçka mbi 8 milion, për vitin 2014 vetëm 78 mijë € kemi ngjirë në arsim.

Në vijim të fjalës së tij z. Limani dha edhe hollësitë të tjera përkitazi me këtë projekt- buxhet të cilin material anëtarët e Kuvendit e kanë pasur si material në kopje fizike.

Zijadin Maliqi- ne e kemi marrë propozim- buxhetin dhe kemi pasur mundësi për ta analizuar, kurse sot i dëgjuam edhe sqarimet u.d të drejtorit për Buxhet dhe Financa dhe ne këtë buxhet duhet ta rekomandojmë për aprovim në KK edhe pse është një buxhet jo i përshtatshëm për Komunën e Gjilanit. Në bazë të analizave që i kam bërë, unë mund të them se ne nëse mbesim me këtë buxhet që është sot, vitin 2015 do ta kemi shumë më të rëndë se sa në vitin 2014. Buxheti gjithsej është mbi 21 milion e 839 mijë € e që duket se është një rritje prej 8.5% në krahasim me buxhetin fillestar. Mirëpo kur i shohim se 14 milion e 150 mijë €, janë për paga, atëherë Komunës i mbeten për të manipuluar me shpenzime tjera operative me 7 milion 690 mijë €. Kjo rritje që është 8.5% është në bazë të granteve dhe formulës që rritet buxheti në nivel qendror, por rritja e pagave që është bërë nuk është shtuar asgjë në buxhetin tonë. Për këtë arsyeje është desh që të gjitha kategoritë e tjera të zvogëlohen për ta mbuluar kategorinë e pagave. Në buxhetin e vitit të kaluar pagat kanë marrë pjesë me 57.81%, kurse këtë vit 64.79%.

Te mallrat dhe shërbimet kanë marrë pjesë me 17%, kurse tash ka ra në 8% dhe në bazë të kësaj shihet si diku mbi 600 mijë € janë më të vogla në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014 dhe për këtë arsyeje do të jetë një vit i rëndë.

Te shpenzimet komunale, gjithashtu kemi zvogëlim prej 3.12% në 2.57% e që është shumë vështirë ta kalojmë këtë vit me këto mjete. Po dëgjoj se ndriçimi publik është ndal për shkak të mungesës së mjeteve për pagesë të energjisë elektrike. E vetmja kategori ku kemi rritje është te subvencionet dhe kjo është e mirë e sidomos ka rritje të subvencioneve në bujqësi. Te investimet kapitale ka rënë dhe kjo e tëra është për shkak të rritjes së pagave, kurse mjete nuk janë ndarë për këtë vit. Mandej borxhet nuk mund t' i kryejmë këtë vit dhe siguri do të mbesin edhe për vitin e ardhshëm dhe viti 2015 do të

jetë mjaft i rëndë. Në këtë vit nuk është bërë rishikim i buxhetit, sepse po të ishte bërë rishikimi i buxhetit me siguri se do të fitonim diçka, por unë vitin 2015 e shoh si një vit bukur të rëndë financiar.

Mirëpo unë jam për ta aprovuar në Kuvend ashtu si është me kërkesa që në të ardhmen të mundohemi që ta përmirësojmë gjendjen.

Nevzad Isufi- çështja e buxhetit ka qenë dashtë të bisedohet edhe në nivele të tjera përpos debatit publik dhe të ekspertëve, ka qenë dashtë të bisedohet edhe në sektor të veçantë dhe të dihen planet e veçanta të secilit sektor. Ne të gjithë po e dimë se buxheti nuk është i mjaftueshëm, por për shkak të pamjaftueshmërisë së tij duhet të kujdesimi që t' i mbulojmë resorët më kryesor që përbëjnë Komunën. Nga kolegu Zijadini u dhanë me shifra dallimet,

sidomos në krahasim me këtë vit dhe vitit të ardhshëm 2015, në të cilin vit vërehet një rënie e buxhetit në të gjitha sektorët. Unë po ndalem te buxheti i këtij viti dhe vitit të ardhshëm dhe te shpenzimet kapitale kemi zvogëlim të buxhetit nga 20 milion, gjegjësisht 1 milion më pak, te shëndetësia kemi zvogëlim për 80 mijë €, në arsim 280 mijë €, te Zhvillimi Ekonomik mbi 1 milion e 500 mijë, në mallra dhe shërbime prej 423 mijë €, në 330 mijë €. Te të gjithë këta sektorë të rëndësishëm të Komunës po shihet se kemi zvogëlim të buxhetit. Mirëpo në anën tjetër kemi rritje të buxheti 13% në krahasim me vitin 2013, kurse në anën tjetër kemi ulje të shpenzimeve kapitale për 10% krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu shpenzimet kapitale për vitin 2015, planifikohen të zvogëlohen për 40% në krahasim me vitin 2014. Shtrohet pyetja se çfarë shërbime mund të bëhen me këtë buxhet, sidomos te mjekësia familjare. Në arsim gjithashtu shpenzimet kapitale janë planifikuar të zvogëlohen 30% në krahasim me vitin 2014. Gjithashtu edhe te Zhvillimi Ekonomik ka zvogëlim 30% në krahasim me vitin paraprak. Në shëndetësi për mallra dhe shërbime parashikohen të zvogëlohen shpenzimet për 25% në krahasim me vitin 2014. Nga të dhënat shihet se investimet kapitale janë zvogëluar për 10% edhe pse buxheti është rrit 13%. Për shpenzimet kapitale nuk kemi sqarime të duhura dhe jo vetëm që janë të përgjithësuara, por nuk përmendet asnjë projekt konkret dhe as që bëhet fjalë për ndonjë prioritet të ndonjë projekti. Ne në vazhdimësi kemi thënë se investimet në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik duhet të jenë në rritje, mirëpo po ndodh e kundërta. Nuk janë paraparë mjete për likuidim të borxheve të Komunës, por edhe ato borxhe të cilat janë paguar nuk janë dhënë sqarime as për ne as për qytetarë, se kujt iu janë shlyer borxhet, personave juridik, apo privat, mandej ku janë marrë ato mjete, mandej sa është vlera e borxhit të papaguar? Nuk figuron asnjë shifër se si do të shlyhen ato borxhe gjatë vitit 2015? Mandej një kërkesë e jona asnjëherë nuk po plotësohet e cila ka të bëjë me pasqyrat tabelare të buxhetit. Shpenzimet kapitale ose subvencionet në arsim janë gjithsej 50 mijë €, e ku paramendoj se këtu përfshihen bursat e studentëve, por ne kemi marrë një vendim që bursat e studentëve të rriten, por kjo rritje nuk figuron askund për vitin 2015.

Mandej çfarë subvencione do të kenë shkollat me këtë rritje, por për fat të keq as në vitet e ardhshme nuk vërehet ndonjë shumë as për vitin 2016, por as për vitin 2017.

Gjithashtu sektori i shëndetësisë ka nevojë për shpenzime dhe subvencione shumë më të mëdha se këto që janë. Tre sektorë, Zhvillim Ekonomik, arsim dhe shëndetësi kemi shumë pak subvencione dhe nuk parashihet asnjë çerdhe e fëmijëve për vitet deri në vitin 2017, asnjë shpenzim kapital e që janë mangësi të këtij buxheti. Zyra e Kryetarit planifikon të shpenzojë 534 € në ditë për mallra dhe shërbime, kurse i tërë sistemi shëndetësor shpenzon 904 € në ditë. Këto janë disa vërejtje tona dhe nuk duhet të jemi të gjithë ekonomistë ose specialistë të kësaj fushe për t' i ditur këto shifra konkrete të theksuara me projekte dhe me shpjegime dhe me tekst, sepse kjo është mënyra më e mirë.

Mevlyde Zejnullahu – unë nuk do të flas me shifra, sepse për këto gjëra dha sqarime të hollësishme kolegu Zijadin i cili është njohës i mirë i financave. Mirëpo unë do ta jap një rezymë rreth planifikimit. Planifikimi i buxheti për vitet 2015, 2016 dhe 2017 është një buxhet shumë përafërt dhe një buxhet shumë i vogël. Do të thotë kemi një buxhet minimal i cili ka një dallim në mes viteve vetëm për mijëra €, me përjashtim të vitit 2014 dhe 2015 vite të cilat kanë një dallim më të madh. Mirëpo u tha nga kolegu Zijadin se viti 2015 do të jetë një vit shumë më i vështirë, sepse po vërehet ecuria e punës se si po rrjedh gjatë këtij viti. Sa i përket të hyrave e njëjta është dhe në vitin 2014 dhe 2015 e kemi një lëvizje shumë të vogël. Sa i përket shpenzimeve kapitale, kam vërejt se te Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka shpenzime pak më të mëdha në krahasim me drejtoritë e tjera dhe pse kjo drejtori e ka një prioritet, sepse ka për qëllim zhvillimin dhe krijimin e kushteve më të mira. Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë e kam vërejt se në këtë drejtori është një shumë tejet e vogël e mjeteve, kurse bujqësia në Komunën tonë është një sektor shumë i madh i cili kërkon investime më të mëdha.

Sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë dhe të Arsimit edhe te këto drejtori kam vërejt se ka shumë pak mjete, mirëpo shpresojmë se këto dy sektorë janë shumë të mëdha dhe do të kemi në të ardhmen grande nga Qeveria, sepse aktualisht jemi Komuna më e pazhvilluar në krahasim me komunat e tjera të Republikës së Kosovës.

Riad Rashiti- sa i përket projekt propozimit të buxhetit për vitin fiskal 2015 dhe vlerësimit të hershëm për vitin 2016-2017, shihet se ky buxhet është një buxhet i cili nuk premtonte asgjë për një zhvillim ekonomik lokal. Mandej ky buxhet rrezikon edhe një qëndrueshmëri stabile të gjendjes financiare të Komunës së Gjilanit. Planifikimi i këtij buxheti në këtë formë si është bërë nuk len asnjë mundësi minimale për një kontinuitet normal të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të Komunës së Gjilanit. Me këtë buxhet janë të rrezikuara të gjitha të arriturat që janë bërë nga qeverisja e suksesshme e viteve të fundit nga PDK-ja. Sidomos rrezikohen të arriturat e politikave zhvillimore në sektorin e bujqësisë, zhvillimit ekonomik, ku ishin krijuar shumë favore dhe mundësi të reja për bizneset dhe fermerët duke ndikuar në rritjen e numrit të punëtorëve në Gjilan.

Këtë vit nuk ka asnjë shenjë pozitive se është duke ndodhur diçka. Gjithashtu edhe planifikimi për tri vitet e ardhshme nuk parasheh. Edhe planifikimi për vitet tjera të ardhshme nuk parasheh gjithashtu asnjë lëvizje pozitive në këtë drejtim. Nuk do të ketë gjasë për të realizuar asnjë premtim të kryetarit të Komunës i cili gjatë fushatës ka premtuar shumë projekte dhe përmirësim të infrastrukturës.

Sa i përket të hyrave vetanake vërehet se është bërë një rritje e vogël, por ne mendojmë se është bërë një vlerësim jo real i këtyre të hyrave dhe nuk mund të realizohen, sepse kemi një rritje 170 mijë €, apo 113% nga gjohet në trafik. Te të hyrat te tatimi në pronë janë planifikuar të hyra më tepër vetëm 52 mijë €, kur dihet se në Gjilan vetëm brenda një viti krijohen dhjetëra mijëra sipërfaqe të reja nga ndërtimet e shtëpive dhe banesave, kurse në anën tjetër rritet vetëm për 52 mijë € tatimi në pronë. Kjo që është propozuar që të ulet baza tatimore do të ndikojë edhe më shumë që kjo vlerë të ulet dhe mos të realizohet plani i të hyrave të buxhetit komunal. Gjithashtu në vitet e ardhshme është hequr edhe planifikimi i të hyrave nga koncesioni një e hyrë e cila kishte një ide dhe strategji për një zhvillim ekonomik lokal dhe kjo e hyrë do të duhej të rritej dhe jo të hiqej krejtësisht. Kjo tregon se Komuna e Gjilanit nuk e ka në plan për ta shfrytëzuar Ligjin e PPP-së dhe për ta zhvilluar edhe më tepër privatizimin dhe për të krijuar të hyra më të mëdha për Komunën. Në përgjithësi ky buxhet i planifikuar për vitin 2014 është në disharmoni të plotë me plotësimet dhe ndryshimet e planifikuara nga ato që kryetari i Komunës i ka planifikuar t' i realizojë. Me këtë buxhet të planifikuar të Komunës së Gjilanit jo që do të vijnë ditë të vështira financiare, por Komuna rrezikohet të funksionojë normalisht ashtu siç po shihet këtë vit. Te të hyrat e tatimit në pronë është planifikuar rritje vetëm për 52 mijë €, kur dihet se në Gjilan brenda një viti krijohen dhjetëra mijëra sipërfaqe të reja të shtëpive dhe banesave, ndërsa me këto dhjetëra mijëra, tatimi në pronë rritet vetëm 52 mijë €. Prandaj kjo që është propozuar që të ulet baza tatimore do të ndikojë edhe më shumë që kjo vlerë të ulet dhe të mos realizohet plani i të hyrave vetanake. Është interesanti fakti se edhe në vitet e ardhshme kryesisht nuk shihet askund planifikimi i të hyrave nga koncesioni? Kjo është një e hyrë që kjo qeverisje duhet ta kishte si ide për një zhvillim ekonomik lokal, por kjo e hyrë është zero €. Kjo tregon se Komuna e Gjilanit nuk i ka synimet askund për ta shfrytëzuar Ligjin e PPP-së dhe të epen mundësitë më të mira për të gjitha investimet private.

Në përgjithësi ky buxhet i planifikuar për vitin 2015 është në disharmoni të plotë me ndryshimet dhe zhvillimet e planifikuara të cilat kryetari i Komunës i ka planifikuar t' i realizojë. Me këtë buxhet të planifikuar jo që do të ketë vite të vështira financiare, por Komuna rrezikon të funksionojë normalisht. Ashtu siç po shihet këtë vit është cenuar

funksionimi i Drejtorisë së Inspeksionit dhe në bazë të kornizës buxhetore shihet se po rrezikohen dy drejtori dhe me këtë po rrezikohet edhe mirëmbajtja e gjendjes aktuale në infrastrukturë, në arsim, shëndetësi dhe të do të ketë mungesë të madhe të përkrahjes së bizneseve, fermerëve, bujqve e të cilët viteve të laura kanë pasur mbështetje jashtëzakonisht të madhe nga Komuna e Gjilanit dhe ministritë përkatëse. Vetëm vitin e kaluar KE ka planifikuar 1 milion grande, kurse këtë vit nuk kemi informacion as për një € grande. Në sektorin e arsimit janë planifikuar të shpenzohen e mbi 12 milion €, kurse për investime kapitale vetëm 2.3%. Kjo tregon edhe njëherë se si planifikohet të shpenzohet buxheti vitin e ardhshëm. Ashtu është edhe në shëndetësi dhe nga 1 milion e 560 mijë €, janë ndarë vetëm 80 mijë €, ose 3% për investime kapitale, ose 68 mijë € më pak se vitin e kaluar. Ashtu kemi zvogëlim edhe në subvencione dhe sektorë të tjerë të shëndetësisë. Me këtë po shihet se Komuna e Gjilanit në të gjitha sektorët ka rënie dhe nuk ka asnjë synim dhe asnjë ambicie zhvillimore.

Arben Maliqi- unë e falënderoj z. Limanin për sqarim të këtij projekt –buxheti për vitin 2015 dhe po shihet se ky buxhet është i pamjaftueshëm, por edhe unë po e quaj buxhet të fukarallëkut. Mirëpo ne jemi mësuar me këtë buxhet dhe u përmenden shumë gjëra te sektori i arsimit dhe shëndetësisë dhe të gjithë folën njëjtë. Mirëpo është e pamundur një Komunë të ekzistojë vetëm me të hyra vetanake me tatim në pronë dhe me gjoba.

Unë po e jap një mendim dhe po e them shkaku pse nuk po kemi mundësi të përparojmë! Arsyeja e parë është pa grande qeveritare dhe pa qeveri asnjë komunë nuk mund të ekzistojë me përjashtim të Prishtinës. Shtohet pyetja se ku i kemi ne ata deputet të cilët i votojmë, kurse ata fare nuk interesohen për komunën tonë, por edhe të tyre. Pse ne nuk bëhemi unik të gjithë atëherë kur është interesi i Komunës sonë. Duhet lënë interesat partiake dhe interesat e shëfave të tyre dhe të angazhohen më tepër për komunën. Komuna e Gjilanit është e shkelur dhe nuk është faji as te kryetari i Komunës, por ai është te ne, sepse i votojmë njerëzit të cilët nuk kanë përgjegjësi dhe janë njerëz të cilët e duan vetëm kolltukun e vetë. Këta deputet që na përfaqësojnë duhet të mendojnë mirë për qytetarët e Komunës së Gjilanit dhe në përgjithësi për komunën. Në të kundërtën Gjilani përsëri do të jetë zorrë qorre.

Sahit Abazi- së pari zonja kryesuese së pari nuk është mirë të përzihesh në terren të PDK-së, sepse nuk u përzjeve në grupin e LDK-së kur e mori fjalën z. Zijadini dhe nuk e pyete se a po flet në emër të grupit apo në emër të tij. E dyta sa i përket këtij buxheti për vitin 2015, Komunën e Gjilanit mund ta quajmë Komunë të gjobave, sepse është një rritje enorme nga 150 mijë €, në 300 mijë euro dhe kjo është mënyra e vetme që ju ta arsyetoni buxhetin. Nga ana tjetër kemi në rënie drastike të investimeve kapitale nga 37% sa ishte këtë vit dhe në vitin që e kaluam në 16%. Ky 16% neve na kthen në vitin 2000-007, kur buxhetet për Komunë kanë qenë këtu diku afër 16%. Ky është jo seriozitet total i juaji për të zgjidhur probleme të qytetarëve të Gjilanit. Nga ana tjetër e kemi një premtim të kryetarit elektorale që ishte investime në bujqësi. Mirëpo në buxhet nuk parashihet as 10% e atij premtimi nuk do të ndodh. I tregoni qyfterëve se i keni mashtruar, sepse nga 1 milion €, premtim t' i ktheni në 105 mijë € është vetëm mashtrim. Ky nuk është buxhet i zorit, sepse ju po e miratoni këtë buxhet, ju e keni planifikuar këtë buxhet, por është qeverisja e zorit për vitin 2015.

Lutfi Haziri- ajo që na bashkon në këtë pikë është se këta kufij buxhetor nuk janë të përbalueshëm, të nevojshëm dhe është një rrugë shumë e ngushtë për qytetarët e Gjilanit. Mua më habit pse nuk po përmendet në asnjë rast që fjalën tonë për këtë buxhet e ka prerë kjo qeveri qendrore. Kjo qeveria na i ka hequr më shumë se 4 milion € nga buxheti, ne i kemi kaluar kufijtë buxhetor dhe nuk kemi kërkuar mjete shtesë të veçanta

ose trajtim të veçantë, as “dëmshtëpërblim”. Ne kemi thënë se Gjilanit minimum i duhen edhe 4 milion €, në mënyrë që vitit 2015 të përballohet me borxhe, kurse viti 2016 po ashtu një rritje graduale. Ne kemi dashtë ta normalizojmë buxhetin me kërkesat që i ka Komuna e Gjilanit. Cila është kjo Qeveri e cila edhe në dorëheqje tash e cila i prenë fjalët e KK-ve. Unë mbështes vetëm afatin ligjor për miratim, sepse ligji e thotë me 1 tetor nëse Komuna nuk e dorëzon qarkoren e dytë, atëherë ministri e vlerëson dhe mund ta sjell një administrator buxhetor. Ne dhe këtë mund ta bëjmë, por duhet të dihet se Gjilani nuk e administron buxhetin, por e administron MEF-i. Nuk dua dhe nuk kam këso qasje politike dhe përkundrazi do të punoj me deputet e rinj të Kuvendit të Kosovës dhe qarkorja finale e 15 tetorit mund të përmirësohet, por në këtë buxhet duhet të hyjë edhe një vendim shtesë. Ky vendim miratohet në parim dhe kjo duhet ta ketë shtojcën plotësuese të mjeteve të cilat i ka kërkuar Gjilani. Duhet ta dini se nuk i paraqesim projektet të cilat i kemi fituar me KE, as me Qeverinë Amerikane dhe as Gjermane.

Për vitin e ardhshëm hyn shkolla e Bresalcit për renovim komplet, ajo e Përlepnicës të cilat shkolla janë program të Bankës Gjermane. Ne do të vazhdojmë për të punuar, por pjesa që i takon Komunës së Gjilanit duhet të respektohet. Kjo ministri aktuale e ka thënë fjalën e vetë, ata na i kanë prerë 4.5 milion, mandej gjysmë milion €, nuk janë paraparë në fondin shëndetësor që nga janari të cilat Komuna duhet t’ i jep si punëdhënës.

Reduktimi është bërë për rritje të pagave të gjithë e dini dhe në mënyrë arbitrare të gjitha shërbimet për 15% janë prerë. Mirë është bërë që janë rrit pagat dhe jam për këtë, por duhet të thuhet se ka prerje nga Qeveria e Kosovës për shkak të rritjes së pagave. Me 1 tetor pagat nuk do të paguhen me rritje për shkak se nuk ka ndodhur rishikimi buxhetor. Të gjithë arsimtarët, punëtorët shëndetësorë nga 1 tetori do të kenë problem për ta marrë rritjen e pagës, sepse nuk kemi rishikim buxhetor. Bëhet pyetja e do të administrohet apo do të zhvillohet Komuna vitin e ardhshëm shtrohet pyetje? Do të administrohet me këtë buxhet me siguri. Ne duhet të punojmë për ta përmirësuar buxhetin, vitin e ardhshëm edhe për mbi 4 milion dhe të shkojmë me rritje graduale në mënyrë që Gjilani të barazohet me komunat e tjera. Ne jemi të dëmtuar edhe në investime dhe në grande dhe nuk janë vetëm ato arsyeje që i tha z. Limani, nxënës pak e mësues shumë, sepse ky është problem i tërë Kosovës. Në parim unë iu lus që ta votoni këtë buxhet, mandej unë propozoj që t’ i shtohet aneksi i buxhetit dhe kërkesa e KK të Gjilanit që në Qarkoren e 15 tetorit, Qeveria e Kosovës ta konsideroj seriozisht dhe të njëjtin dokument do t’ ia dërgoj të gjithë deputetëve të Komunës së Gjilanit, duke i sjell vlerësimet dhe krahasimet me komunat e tjera. Vetëm një komunë e Kosovës i ka marrë 17 milion €, për ta ndërtuar një rrugë! Vetëm në një Komunë të Kosovës kanë hyrë 17 milion € investim, kurse e tërë Komuna e Gjilanit i ka 4 milion €. Unë këtë do t’ ia dërgoj të gjithë deputetëve dhe të votojnë si të duan në fund. Një Qeveri e cila nuk vendos drejtë dhe nuk vendos parametra të drejtë e ndanë përgjegjësinë me neve.

Sa i përket gjobave jam i interesuar për t’ i ulur në zero, por kjo i atribuohet efikasitetit të Policisë së Komunikacionit dhe ata e kanë kryer punën e vetë në mënyrën më të mirë të mundshme. Mua më vjen keq nga gurbetçarët të cilët kanë pasur pasoja, por unë jam që gjobat të jenë në nivelin zero, por disiplina në trafik është kujdes ndaj jetës dhe pronës.

Mirëpo kjo nuk ka të bëjë me Komunë dhe ne marrim para edhe nga gjykatat, sepse gjykata e kryen punën e vetë dhe ato të hyra janë të ndara dhe një përqindje i takon Komunës. Për ta përfunduar këtë raport është e vërtetë se ky buxhet jo që është i pamjaftueshëm, por është zero në krahasim me kërkesat e Komunës së Gjilanit.

Të punojmë bashkë që së paku në qarkoren e parë ta kthejmë gjendjen dhe këto janë kërkesat që mundet Qeveria për të gjet zgjidhje. Ne i tregojmë Qeverisë se nga i merr parat, i merr 4 milion nga ajo rrugë që i ka paraparë 17 milion për ta ndërtuar, sepse ajo

rrugë nuk është e nevojshme fare dhe e tërë Kosova e dinë se nuk ka nevojë të ndërtohet, prandaj t'ia jep Gjilanit pjesën e vetë dhe kështu barazohemi me kufij buxhetor. Sa i përket KE deri më tash kemi marrë një konfirmim se një operator në Gjilan i ka fituar 300 mijë € grand. Ministria e Bujqësisë dhe Banka Botërore e kanë në fazën e vlerësimeve, Ministria e Industrisë dhe Komuna, aplikacionet e tjera i ka në shqyrtim dhe numri më madh i aplikantëve që ka pasur interesim për të aplikuar është asistuar dhe përfitues janë ata. Ju falënderoj për durim.

Bujar Nevzadi – po e llogarisim se këto që i thatë qëndrojnë, por ju lus ju asnjë fjalë nuk e thatë për punën e institucioneve komunale. Gjatë tërë fjalës së juaj u morët me Qeverinë e Kosovës, por sa zyrtarë të Komunës së Gjilanit po bëjnë përpjekje për ta grumbulluar buxhetin dhe për ta kryer punën e vetë? Unë po pajtohem se ka gabime nga lartë, por na thoni sa punëtorët tanë po e kryejnë punën e vetë? Unë filloj nga vetja, pasi ta kryej punën time, pastaj e qes hapin jashtë shtëpisë sime !

Lutfi Haziri- për të qenë shumë i qartë edhe njëherë po e përsëris se për herë të parë si kryetar i Komunës më ka ra hise për ta paraqitur në mënyrë ligjore buxhetin dhe për herë të parë e kërkoj nga Qeveria. Deri më tash kërkesat e mia në Qeverinë e Kosovës për vitin 2014 janë realizuar 100%. Çdo kërkesë e imja e adresuar në çdo ministri është kthyer pozitivisht. Në çdo ministri që kam kërkuar dhe buxhet edhe në projekte dhe mbështetje ligjore, në afat ligjor dhe më parë se afati ligjor kanë reaguar dhe kam marrë përgjigje. Këtu hyjnë edhe investime, bashkë investimet si është rruga “ Mulla Idrizi” dhe Zabeli i Sahit Agës. Ne tash për herë të parë po dërgojmë buxhet dhe këtu tregon Qeveria sa është përkushtuar, ne nuk po kërkojmë benificion në buxhet, por ne po kërkojmë një barazi në buxhet dhe asgjë tjetër. Ende nuk është thënë fjala kryesore, sepse më 15 tetor sipas ligjit është qarkorja e fundit, mandej Qeveria duhet të vendos, kabineti qeveritar ka të drejtë të bëjë lëvizje të kufijve dhe në fund Kuvendi i Republikës në dhjetor. Kjo është veprimi i parë që ne po e adresojmë bashkë dhe nëse e arrijmë qëllimin ne nuk mund të themi që kjo Qeveri nuk iu ka përgjigj kërkesave tona. Kjo është sfida e parë të cilën ne së bashku duhet ta fitojmë.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesja propozon që të aprovohet pika 3.2 e rendit të punës

Aprovohet pika 3.2 e rendit të punës: Projekt propozimi i Buxhetit për vitin fiskal 2015 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2016-2017, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët nuk u deklaruan për asnjërin variant të votimit

Pas aprovimit të pikës 3.2, kryesuesja në ora 12.30 i liron në pushim anëtarët e Kuvendit deri në ora 13.30 min. Mirëpo përmes sms-së kryesuesja i njoftoi anëtarët e Kuvendit, se punimet e seancës do të vazhdojnë në ora 14.

Deri në ora 14.13 minuta, kryesuesja nuk erdhi në sallë për t' i vazhduar punimet e seancës, kurse grupi kuvendar i PDK-së dhe LVV nuk priten më gjatë dhe dolën nga salla e KK-së.

3.4- Plani Komunal për efikasitet të energjisë 2014-2020

Në ora 14.15 minuta, kryesuesja kërkoi që të vazhdohet me rend të punës, por së pari kërkoi nga sekretaria që të konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit.

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës ishin të pranishëm 22 anëtarë të Kuvendit, kurse 13 munguan.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- koha e vonësës sonë ka qenë 10 minuta dhe nëse dikush dëshiron të bëjë skandale dhe ta bëjë cirk çështjen e vonësës është e drejtë e tyre dhe personalisht ata vendosin për veten e tyre. Arsyeje për të lëshuar seancën aspak nuk kanë, sepse ne jemi njerëz dhe ndodhin vonesat së paku deri në 15 minuta. Pasi që ka kuorum për të vazhduar me punë, kryesuesja e Kuvendi, përkitazi me pikën 3.4 fjalën ia bartë drejtorit të Shërbimeve Publike.

Sokol Haziri-- në pika të shkurtra po i jap disa sqarime dhe po theksoj se ky është një plan për kursim të energjisë dhe jo vetëm energjisë elektrike, siç thuhet, por energjisë në tërësi që përdoret në Komunën e Gjilanit dhe ka të bëjë kryesisht me objektet, jo të banimit, jo rezidente do të thotë që përdor Komuna në objekte të Gjilanit. Për këtë rast ka punuar një komision, emrat e të cilëve i keni në shkresat e lëndës e të cilët janë ekspert të lëmisë përkatëse e të cilët e kanë rekomanduar me qëllim që të ketë një kursim e që ka të bëjë me harxhim më racional të energjisë elektrike.

Ju e keni materialin në tërësi përpara dhe unë mund t'iu them se ky është një plan të cilin e kërkon edhe BE-ja, aty ku synojmë të integrohemi, por që më së tepërmi i nevojitet Komunës së Gjilanit për të cilin plan është punuar edhe më herët. Kjo është një punë e përbashkët e të gjithëve dhe kisha propozuar ta rekomandoni për aprovim në Kuvend, sepse është interes i përgjithshëm.

Avdyl Aliu- siç u tha edhe nga drejtori Ligji për efikasitet të energjisë i miratuar në qershor të vitit 2011 në Kuvendin e Kosovës i obligon komuna që të hartojnë Plan komunal për efikasitet të energjisë. Në funksion të kësaj KK i Gjilanit e ka formuar komisionin të cilit komision i shpreh mirënjohje për punën kryer lidhur me efikasitetin e energjisë për vitin 2014-2020.

Ky është një plan i cili për çdo ditë rishikohet, sepse për çdo ditë krijohen edhe rrethana të reja. Objektivat e këtij plani janë që të reduktojë konsumin e energjisë në stafin e banesave, në transport dhe ndriçim publik etj.

Shpresojmë se ky plan do të ketë ndikim në përmirësimin e shërbimeve komunale, reduktimin e kostos së energjisë në buxhetin komunal, në përmirësimin e kushteve sanitare dhe rritjen e produktivitetit, ngritjen e vetëdijes për kursim të energjisë etj.

Në emër të grupit të anëtarëve të Kuvendit të LDK-së e aprovojmë këtë dokument me mjaft rëndësi për KK të Gjilanit.

Isa Agushi- unë si kryesues i Komitetit për Shërbime Publike e kemi rekomanduar këtë plan edhe në këtë komitet dhe njëzëri jemi pajtuar që ky plan të miratohet. Ne kemi biseduar mjaft me kompetencë dhe jemi pajtuar që ky plan sot të aprovohet.

Selami Xhemajli- e falënderoj drejtorin për sqarimet të cilat na i dha, komisionin për punën që e a ka bërë në hartimin e planit strategjik dhe në emër të grupit të AAK-së t'iu jap mbështetje për aprovim në Kuvend këtij plani i cili do të shërbejë për efikasitet të energjisë elektrike, por edhe për kursim të buxhetit.

Arben Mehmeti- nga rrethanat praktike ne e kemi vërejt se në terren ka lloje të ndryshme të diskriminimit sa i përket ndriçimit publik. Prandaj unë mendoj se sot përmes këtij Plani, Drejtoria për Shërbime Publike do ta vendos në binar pozitiv(vërejtja i drejtohet qeverisë së kaluar) të cilët kanë lejuar që nëse në një rrugë ka pasur një zyrtar të lartë në kuadër të Komunës e ka pasur ndriçimin jashtëzakonisht të mirë, kurse aty ku nuk ka pasur zyrtar të lidhur me pushtetin nuk ka pasur as ndriçim. Ka qenë një praktikë e gabuar e qeverisjes së kaluar dhe dëshiroj që kjo dukuri negative në të ardhmen mos të përsëritet. Mirëpo edhe

ndriçimi publik duhet pasur njëfarë prioriteti duke filluar nga qendra dhe në zona të tjera, sepse ka disa ditë që në “Dardani” nuk ka pasur ndriçim publik. Mandej edhe organi mbikëqyrës duhet të jetë në nivel të detyrës, sepse në rrugën në drejtim të Velekicës janë vendosur disa poça elektrike shumë të vogla të cilat nuk kanë dritë të mjaftueshme.

Mandej e kam edhe një rekomandim për Drejtorinë e Shërbimeve Publike që t’i rishqyrtojë komisionet e këtij projekti të cilët duhet të jenë njerëz profesional, por edhe të sinqertë të cilët nuk bëjnë diskriminime në baza politike etj.

Ismajl Jonuzi- desha të reagojë ndaj fjalës së z. Mehmeti, se këtu është fjala për efikasitet të energjisë, nuk është plan për ndriçim publik dhe nuk e zgjidh atë problem. Ky plan kryesisht ka të bëjë me kursimin e energjisë elektrike dhe përfaqësuesit e Gjermanisë janë befasuar shumë kur e kanë parë këtë draft plan i cili është obligativ dhe ligjor për çdo Komunë. Në takime me Qeverinë Gjermane kemi arrit një listë investime mbi 1 milion € , sa i përket efikasitetit të energjisë elektrike.

Arben Mehmeti- së pari nuk po i kam të qarta kompetencat e Drejtorisë Publike dhe e dyta ndriçimi publik nëse nuk ka lidhje me energji, atëherë unë e pranoj gabimin.

Unë i përmenda disa raste si është rasti me poçat elektrike e të cilat janë në funksion të realizimit të një projekti sa më efikas dhe në shërbim të qytetarëve pa diskriminim.

Bajram Hasani- unë nuk po bëj ndarje, por po ndërlidhem te ndriçimin lidhur me fjalën e Arbenit. Për Lagjen “Dardania”, unë nuk e di si janë lidhur kontratat, por aty nuk ka funksionuar afër 10 ditë ndriçimi publik. Mirëpo edhe tash ai ndriçim nuk po mirëmbahet e që ma merr mendja se me pak shpenzime mund të bëhen disa përmirësime.

Kërkoj nga drejtori i Shërbimeve Publike që të kenë kujdes dhe të mos bie niveli i ndriçimit sepse në mandatin e kaluar ka funksionuar shumë mirë.

Sadullah Kadriu- edhe unë kam një vërejtje, sepse në lagjen “Dardania” 10 ditë nuk ka pasur energji elektrike (ndriçim publik). Mirëpo unë kam një vërejtje tjetër, sepse në disa lagje dy orë para se të bie errësira, energjia elektrike aktivizohen. Do të duhet që ndriçimi publik të aktivizohet kur e ka kohën dhe jo dy orë para kohës, sepse kjo shkon në dëm të Komunës, ose atij që i kompenson ato shpenzime.

Arben Maliqi- kjo çështje është interes të gjithëve, por pasi që i takoj lagjes “Dardania” ka ndodh një javë që nuk ka pasur dritë, por kanë qenë disa arsyeje (mos pagesa).

Mirëpo unë mendoj se shërbimet publike janë duke e kryer një punë të mirë, ka disa mangësi diku-diku, por në përgjithësi është duke u bërë një punë e mirë për pa bërë asnjë diskriminim dhe ne vetëm mund t’i urojmë suksese.

Sokol Haziri- të gjitha shqetësimet që u paraqiten në këtë rast janë diçka reale, por është një mungesë, sepse në Dardani dhe në disa fshatra nuk ka qenë funksional ndriçimi publik, por jo për shkaqe teknike. Ju i dini se si janë zhvillimet në qendër, rishikim të buxhetit nuk ka pasur dhe shoqëritë financiare nuk kanë arrit në nivelin lokal.

Unë mund t’i kërkoj falje të gjithëve, sepse ne tash kemi të bëjmë me një kompani private dhe nuk është më KEK-u i cili ka pasur një karakter publik, me të cilët kemi pasur mundësi të akordohemi. Mirëpo nganjëherë fal stafit nganjëherë po gjejmë mirëkuptim që ndriçimi publik të jetë funksional edhe në mungesë të mjeteve. Zgjerimin e rrjetit po e shfrytëzoj rastin t’iu përgjigjem Arbenit se disa poça janë shumë të dobëta, por pikërisht ato poçe efikase të cilat ndriçojnë më pak, por që kursejnë shumë ose katër poça të këtilla bëjnë sa një me standarde tjera. Për këtë arsyeje unë kam urdhëruar që të bëhet ndërrimi i poçave me ato ekonomike dhe jo ekonomike. Diskriminim nuk do të ketë absolut, kjo qeveri është e

përkushtuar për të gjithë njëjtë (Qeveria Komunale) ne dhe në sektorin e efikasitetit do të mundohemi t' i përfshijmë të gjithë sektorët, prandaj kjo është e tëra.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 3.4 e rendit të punës? Aprovohet pika 3.4 e rendit të punës: Plani Komunal për efikasitet të energjisë 2014-2020, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit.

3.5 Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- në këtë pikë është një debat dhe informatë e cila nuk ka nevojë të votohet. Mirëpo kjo është edhe një arsyeje shtesë për opozitën të cilët dolën nga salla, sepse e kanë ditur se do të vijë kjo pikë.

Zijadin Maliqi- ky raport është i vitit 2013, do të thotë i qeverisjes së kaluar për të cilin do t' i them disa fjalë në vija të trasha. Sa i përket pasqyrave financiare është dhënë një opinion pozitiv nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrat financiare pasqyrojnë një pikëpamje të drejtë në të gjitha aspektet materiale. Për këtë arsye vlerësimi i pasqyrave financiare nga ana e Auditorit është opinion i pamodifikuar, me theksim të çështjes, do të thotë se janë thënë vërejtje të mëtejme !

Mirëpo në vijim Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dhënë një numër bukur të madh të vërejtjeve gjatë punës së vitit 2013. Së pari ka vërejtje për mos adresim të rekomandimeve, do të thotë mos plotësimin e rekomandimeve të cilat janë dhënë nga Zyra e Auditorit, se pse prej 18 rekomandimeve të cilat janë dhënë, vetëm 4 janë adresuar plotësisht, 7 (shtatë), pjesërisht , kurse 7 (shtatë) nuk janë prekur fare. Këto lëshime nuk janë vetëm të një viti, por janë të disa viteve e të cilat rregullisht janë dhënë. Vërejtje tjetër është ndërrimi i destinimit të mjeteve financiare dhe theksohet se nga investimet kapitale është paguar një shumë e mjeteve mbi 19 € për subvencione dhe mbi 2 mijë e 800 € për mallra dhe shërbime, do të thotë pa vendim të Kuvendit është ndërruar destinimi i mjeteve, e që është në kundërshtim me ligjin. Vërejtje tjetër është mos regjistrimi i pasurisë (këto raste nuk mund të gjitha t' i gjej auditimi), por merren mostra dhe në bazë të atyre mostrave janë nxjerr këto të gjetura. Mos regjistrimi i pasurisë, ka vërejtje te objektet shkollore në vlerë prej mbi 3 milion e 700 mijë €, të cilat nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë paraqitur në pasqyrat vjetore financiare. Vërejtjet më të mëdha janë dhënë në Zyrën e Prokurimit siç janë: pagesat e organeve mbikëqyrëse dhe i komisionit për pranim teknik, përmes operatorëve ekonomik.

Tjetër vërejtje është vonesat në kryerjen e punëve (nuk është theksuar se kush është fajtor për vonesë të kryerjes së punëve), sepse ka projekte të cilat kanë zgjatur me vite dhe nuk kanë përfunduar. Tjetër vërejtje është se ka raste kur menaxheri i projektit ka qenë edhe kryetari i organit mbikëqyrës. Tjetër vërejtje është se formimi i kompanive, dy kompanive, brenda një kompanie të cilat marrin pjesë në tender, por me dokumentacion të njëjtë. Mandej lidhja e kontratave pa zotim të mjeteve e që është në kundërshtim që ka krijuar dhe krijon obligime e të cilat janë bartur edhe vitin e ardhshëm. Vërejtje tjetër është pagesa e subvencioneve për pa e zbatuar Rregulloren përkatëse për subvencione, sepse ka disa raste që mbi 2 mijë € i ka paguar vetë kryetari pa e marrë pëlqimin nga Kuvendi. Ka vërejtje në kontrollin e punëve nga menaxhmenti i lartë i Komunës, ka vërejtje në drekat zyrtare, sepse nuk dihet për kë është dhënë dreka zyrtare, sa pjesëmarrës janë në dreka zyrtare dhe qëllimi pse janë dhënë ato dreka?

Gjithashtu ka vërejtje edhe për pranim të punëtorëve pa konkurs publik e që e paraqet si një rrezik në buxhetin e Komunës. Në fund vërejtja më e madhe është te obligimet të cilat i ka krijuar Komuna në kundërshtim me ligjin. Ka edhe një numër mjaft të madh të vërejtjeve, por

unë nuk u zgjerova shumë, por këto lëshime janë për pushtetin për t' i analizuar dhe t' i adresojë si duhet rekomandimet të cilat janë dhënë.

Avdyl Aliu – nëse themi se misioni i ZAP-it është që të kontribuojë në menaxhimin e shëndosh financiar me paranë publike dhe në këtë mënyrë edhe të ndërtojë besim për mënyrën e shpenzimit të parasë, do të thotë t' i sigurojë taksapaguesit se parat e tyre shpenzohen drejtë dhe mirë. Mirëpo ne lirisht mund të themi se në Komunën e Gjilanit ky mision ka dështuar plotësisht. Duke e ditur dhe duke e parë se sa negativ është ky raport, unë përsëri dyshoj në cilësinë e këtij auditimi! Gjithashtu ky raport është larg në përputhje me standardet ndërkombëtare nga fusha e auditimit. Mirëpo sido që të jetë edhe kështu si është i ka dhënë një hije të zezë Komunës dhe e vë në dyshim taksapaguesin e Komunës. Ne duhet të bëjmë shumë për ta rikthyer besimin e taksapaguesve dhe jemi në rrugë të mirë, sepse po kursejmë dhe po i kryejmë obligimet e kaluara.

Ky raport është për plotë me përfundime negative, Komuna ka bërë keq klasifikim të shpenzimeve, sepse nga kategoria e investimeve kapitale ka paguar për mallra dhe shërbime, kurse sistemi fiktiv i kontrollit të brendshëm nuk ka funksionuar në nivel të kënaqshëm. Përdoret në shumë vende fjala lëshime, pasaktësi, gabime dhe do të thotë kontrole të dobëta në fushën e menaxhimit të pasurisë etj. Rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë zbatuar. Kontratat janë menaxhuar dobët e të cilat kanë përfunduar me vonesë në kryerjen e punëve dhe rritja e vazhdueshme e obligimeve, për dreka zyrtare nuk ka arsye të mjaftueshme pse janë dhënë, mandej kostoja e tyre.

Nuk është bërë asgjë lidhur me obligimet e papaguara të cilat kanë qenë të identifikuar më herët. Nuk është bërë kurrë asnjëherë asnjë kontroll për punën e prokurimit në të cilin sektor janë gjetjet më të mëdha dhe më të theksuara. Ka pasaktësi në vlerësim të pasurive të Komunës, ka pasaktësi në raportim të obligimeve dhe dështim të përgjithshëm në këshillat e ZAP-it. Mua më vjen keq që nuk është opozita këtu, sepse shefi i opozitës kishte lexuar diçka në faqen 14 dhe në mbledhjen e KPF-së dhe theksoi se e tërë puna e Komunës është pasqyruar në faqen 14? Unë e kam lexuar faqen 14 dhe si konkluzioni përgjithshëm thotë: “ ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, por nuk zbatohen në praktikë dhe nuk ishin aq sa duhet funksionale” vazhdon citati.

Unë nuk e di se çka ka parë tjetër gjë në faqen 14 shefi i grupit të PDK-së me të cilën ne duhet të mburremi?

Isa Agushi- ne e dëgjuam me vëmendje kolegun tonë Zijadin, se në këtë raport të auditimit ka shumë shkelje. Pyetja e ime është a ka marrë ndokush përgjegjësi dhe a është burgos ndonjë përgjegjës për të gjitha këto shkelje? Mandej kush duhet të bëjë padi, auditori, Kuvendi, kryetari apo drejtoritë? Unë po shoh shumë shkelje të rënda, prandaj duhet duksh të jep llogari njëherë e përgjithmonë në mënyrë që mos të ndodhin në të ardhmen gjëra të tilla. Nëse në këto pyetje dikush mund të më jap përgjigje do ta kisha dëgjuar me vëmendje!

Valentina Bunjaku-Rexhepi – gabimet e qeverisë së kaluar të hyjnë në raport dhe të përmirësohen, sepse ka hapësirë të madhe për përmirësim dhe janë bërë shumë gabime. Ky raport nuk votohet, por vetëm debatohet, por kërkoj nga sekretari që ta evidentojë se ne në emër të Kuvendit kemi kërkuar që të përmirësohen këto gabime të ish qeverisjes së kaluar. Mirëpo kërkoj që raporti i Auditorit të mbetet si temë debati edhe në seancë e radhës së bashku me propozimin për plotësim dhe ndryshim të statutit. Besoj se opozita do të jetë prezentë dhe do t' i shohin gabimet e tyre.

Valentinëp Bunjaku- Rexchepi- kush është që edhe Raporti i audimit përsëri të jetë si pikë e rendit të punës në seancën e radhës

Aprovohet kërkesa e kryesuese me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në punimet e kësaj seance, që Raporti i Auditorit të debatohet edhe njëherë në një seancë të radhës.

3.6 Propozim vendimin mbi qasjen e hartimin e Planit të hollësishëm rregullues; “Qendra-4” në Gjilan

Për këtë pikë të rendit të punës, kryesuesja e Kuvendit fjalën ia bartë drejtorit të Urbanizmit për të dhënë sqarime.

Valon Shefkiu- përkritazi me këtë projekt para anëtarëve të Kuvendit, z. Shefkiu i dha sqarimet me anë të kino-projektorit.

Nevzad Rushiti- desha ta jap një sqarim se kjo është zonë e qendrës së qytetit, prandaj kam pyetje se a e ka menduar Drejtoria se këtu duhet të bëhen ndërtime të larta dhe në sa kate? Këtë pyetje po bëj, sepse unë kam kërkesa nga investitorët e ndryshëm që në këtë zonë dhe shumë zona të tjera të qytetit brenda unazës të ndërtohen objekte mbi 6 kate. Këto janë kërkesa të investitorëve të cilët mendojnë për të punuar në Gjilan.

Imet Rrahmani- edhe unë e kam një pyetje të ngjashme teknike; a ka mundësi të realizohet hapja e një rruge në atë lagje pasi që këtu ka edhe prona private? Një numër i madh i nxënësve i vijnë mësimet në Shkollën Fillore “Abaz Ajeti” dhe me hapje të kësaj rruge do të zgjidhen shumë probleme?

Arben Mehmeti- ndoshta nuk është çështje e sekretarisë, por edhe sekretarisë është mirë që t’i sigurohet një kompjuter me ngjyra për ta parë materialin (projektin), për ta parë materialin më mirë se për çka po debatojmë. Për ndryshe mos na sillni fare material, sepse në këtë mënyrë nuk po vërejmë asgjë! Kjo është çështje jo serioze dhe këtë praktikë e kemi pasur edhe në të kaluarën dhe të cilën kemi kërkuar që të përmirësohet.

Sa i përket planifikimit në këtë zonë, aty aktualisht ka ndërtime, ka ndërtime pa leje, mbindërtime etj. Si rregullohet ky aspekt a është një lloj legalizimi apo si do të ndodh kjo?

Arben Maliqi-ky propozim për qasje të këtij Plani është ashtu si është edhe shumë plane të tjera që i kemi aprovuar, por iu dëshiroj të bëhen ashtu siç i ka hije dhe nuk dyshoj fare në aftësitë e drejtorit dhe stafit të tij. Mirëpo është mirë që të analizohet mirë ashtu siç i ka hije dhe të bëhen ndryshime ashtu si dëshirojnë individët, ashtu si ka ndodhur më parë.

Është mirë që me këtë punë të merret një staf profesional dhe të mendohet dhe analizohet mirë, sepse në këtë pjesë ka bukur shumë probleme.

Rina Ahmeti-në emër të anëtarëve të Komitetit për Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit këtë propozim vendim mbi qasjen e hartimit të Planit të hollësishëm “Qendra 4” ne me të gjithë anëtarët e këtij komiteti e kemi elaboruar së bashku me drejtorin e Urbanizmit dhe e kemi parë të arsyeshme që të miratohet për të mirën e qytetit.

Bajram Hasani- edhe unë e mbështesë këtë propozim-projekt, sepse edhe unë jam anëtarë i Komitetit të Urbanizmit dhe në atë komitet e kemi analizuar mirë këtë çështje, por kemi kërkuar nga drejtoria që vetë ta hartojnë këtë projekt, sepse jam i bindur se ka profesionist për

këso punë dhe mos të angazhojnë kompani nga jashtë siç ka ndodhur më parë. Mirëpo duhet pasur parasysh edhe kërkesat e qytetarëve dhe bizneseve, sepse aty është një zonë industriale. Dëshirojmë që Drejtoria e Urbanizmit ta hartojë këtë plan me shumë kujdes, sepse është zonë e qendrës.

Avdyl Aliu- në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së e përgëzoj Drejtorinë për Urbanizëm për një punë të mirë të cilën po e merr për obligim për ta kryer në vazhden e punëve të mira të cilat janë duke u bërë në këtë drejtori. Kjo pjesë e qytetit të qendrës paraqet një pjesë shumë të rëndësishme të qytetit dhe këtu ka një hov të vrullshëm në zhvillim, prandaj drejtoria duhet ta përgatiti këtë plan dhe ky plan t' i paraprijë këtij zhvillimi. E mira është se ky plan rregullues është i pari në 6-7 vitet e fundit që bëhet nga drejtoria, do të thotë pa pagesë dhe pa shpenzime.

Drejtorja duhet të bashkëpunojë me të gjithë faktorët relevant, prandaj iu ftoj që ta aprovoni këtë plan rregullues.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që ta aprovonjë pikën 3.6 të rendit të punës?

Aprovohet pika 3.6 e rendit të punës: Propozim vendimin mbi qasjen e hartimin e Planit të hollësishëm rregullues; "Qendra-4" në Gjilan, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, me sugjerimet dhe vërejtjet e dhëna.

3.7 Kërkesë për përkrahje financiare të Florie Mehmetit nga Gjilani për operim të syrit

Imet Rrahmani- Komiteti për Shëndetësi me datë 17.9.2014, ka shqyrtuar kërkesën e zonës Florie për ndihmë financiare e cila ka një problem të madh shëndetësor i cili problem nuk mund të zgjidhet në institucionet shëndetësore të Kosovës. Zonja Florie, njërin sy e ka të humbur më herët, por tash i kanoset rreziku edhe në syrin tjetër dhe ekziston mundësia nëse nuk mjekohet që t' i dëmtohet edhe syri tjetër dhe ta humb edhe syrin tjetër. Shërimi i kësaj zonje duhet të bëhet në Shqipëri në një Klinikë Italiane dhe në bazë të faturave që na janë afuar i tërë shërimi i saj kushton 12 mijë e 800 €, por një sasi të mjeteve zonja në fjalë e ka siguruar nga burimet e tjera. Neve na është kërkuar që ne t' i ndihmojmë në shumë prej 6 mijë e 600 €. Ekziston vullneti i madh i kryetarit Haziri për t' i ndihmuar rasteve të tilla, prandaj iu ftoj që ta aprovonjë këtë sasi të mjeteve për shërim të zonjës Florie.

Mirëpo iu bëj ftesë të gjithë juve, kryetarit, Lutfi Haziri dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të gjitha instancave tjera që sa më parë ta formojnë fondin për sigurime shëndetësore. Kjo nuk është mënyra për të pasur mundësi që ne si Komunitet t' i ndihmojmë të gjitha rasteve të tilla. Unë iu ftoj që ta votoni këtë rekomandim, me dëshirë që herëve të tjera mos të biem në këso situata.

Shpresë Kurteshi- ne jemi për t' i përkrah rastet e tilla e që fatkeqësisht nuk janë të pakta në numër. Mirëpo për këtë rast dëshiroj ta di se si bëhet bartja e mjeteve? A do të bëhet pagesa përmes xhirollogarisë së Klinikës ku shërohet, apo në xhirollogari private?

Imet Rrahmani-pas debatit në Komitet, një delegacion nga Gjilani kanë qenë në Klinikë ku do të kryhet intervenimi dhe është bërë kontrata që mjetet do të lëshohen përmes xhirollogarisë dhe pagesa mos të bëhet me para kesh në mënyrë që mos të ketë asnjë dyshim!

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet pika 3.7 e rendit të punës për t' i ndarë një sasi të mjeteve për shërim të zonjës Florie Mehmeti.

Aprovohet pika 3.7 e rendit të punës: Kërkesë për përkrahje financiare të Florie Mehmetit nga Gjilani për operim të syrit, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit

3.8- Propozim vendimin për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për nevojat e rrugës publike –Shkolla e Zabelit

Kryesuesja e Kuvendit për ta arsyetuar këtë pikë të rendit të punës para anëtarëve të Kuvendit, fjalën ia bartë, kryetarit të Komitetit për Pronë, z. Nevzad Rushiti

Nevzad Rushiti- kjo është një kërkesë nga Këshilli i Shkollës, kurse iniciator është kryetari i Komunës, sepse edhe me ligj lejohet që të bëhet këmbimi i pronës publike i cili ligj është në fuqi që nga viti 2013. Prandaj duke e marrë për bazë interesin publik, sidomos të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të asaj pjese, ne kemi debatuar në komitet dhe kemi bërë një rekomandim për lejimin e këmbimit të kësaj prone. Ju materialin e keni të gjithë dhe këtu diku prona është përafërsisht 100%, mbi 11 ari me 12 ari është ndërrimi, me një pronë publike e cila është e Komunës me një pronë e cila është e përshtatshme për përdorim. Mirëpo këtë e lejon edhe ligji duke theksuar që pronat të cilat ndërrohen duhet të jenë sa më të afërta.

Unë si kryesues i Komitetit dhe një zyrtar i Komunës e kemi vizituar pronën dhe ajo shkollë në bazë të pozitës të gjeografike, realisht i takon që kjo rrugë të jetë aty, pasi që hyrja është e punuar qysh me kohë, janë shkallët, dyert janë të rregulluara dhe është menduar për ta pasur një lëvizje më të lirë të nxënësve dhe mësimdhënësve. Unë si kryesuesi i komitet e bëj një kërkesë nga ju anëtarët e Kuvendit që në emër të grupit të LDK-së ta votojmë, por normal që duhet kompletuar me dokumente tjera përcjellëse dhe me parametrat e tjera për t' u bërë ky vendim i plotfuqishëm.

Isa Agushi- unë kërkoj që dokumentacioni të jetë i saktë, i kompletuar dhe mos të jetë asgjë në kundërshti me ligjin, sepse në të kundërtën dikush duhet të jep përgjegjësi. Ndërrimi pronës private me ato publike, pa marrë parasysh se është në pyetje shkolla, sepse dikush do të jap përgjegjësi. Duhet të kemi kujdes me letra të jetë vendimi i mbuluar mirë dhe të punohet në mënyrë ligjore dhe jo me paushallë.

Sadudin Berisha- jam i thirrur për ta shpjeguar para anëtarëve të KK-së kërkesën e kryetarit të KK-së për këmbim të pronës për nevojat e rrugës së Shollës së Zabelit kërkuar nga Këshilli i Shkollës. Mirëpo kërkesa për këmbim mbi bazën ligjore për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës nuk është e kompletuar dhe për këtë Drejtoria e jonë ka proceduar në pajtim me ligjin dhe kërkesave drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit për të dhënë informacion të kërkuar për atë pjesë të qytetit të Gjilanit.

Përgjigja në kërkesën tonë ka qenë që për këtë pjesë të qytetit është në procedurë përgatitja e planit rregullues urbanistik, por edhe për infrastrukturë rrugore, nëntokësore dhe sipërfaqësore si nevojë për banorët e kësaj lagjeje.

Kërkesa është gjysmake, sepse nuk përmban kërkesën për këmbim të të gjitha ngastrave kadastrale sipas librave tanë kadastral ku përkufizohen në drejtim të shkollës e që aktualisht rruga e shkelur nga qytetarët është pronë ekskluzivisht private. Këtë e kam thënë edhe në takimin e komitetit përkatës që kjo lëndë të pezullohet deri në një kohë kur të plotësohen të gjitha kriteret dhe kushtet ligjore të miratimit të planit rregullues urbanistik për këtë zonë që është në procedurë, në të kundërtën ky Kuvend do të miraton një kërkesë gjysmake dhe të

paqartë dhe do të prejudikonte zgjidhje urbanistike gjysmake. Jam dhe do të jem që të respektohen rregullat ligjore, të ndërtojmë infrastrukturë moderne ligjore me plan rregullues urbanistik e jo zgjidhje të përkohshme dhe jo të qëndrueshme, ashtu siç ka vepruar qeverisja e deridjeshme.

Për këtë arsyeje unë jam i thirrur t' i mbroj ligjet dhe rregullat ligjore edhe më shumë se drejtori i Urbanizmit. I kam rekomanduar me shkrim kryetarit të Komunës që të pezullohet kjo çështje deri në plotësimin e kushteve ligjore. Kërkesa e kryetarit ka qenë që unë nuk do të nënshkruaj aktvendime që janë në kundërshtim me ligjin. Dhe është thënë që kjo të tërhiqet nga debati dhe diskutimi dhe të vendoset në një nga seancat e radhës kur të plotësohen kushtet ligjore.

Avdyl Aliu- kjo po bëhet për Shkollën e Zabelit dhe unë jam moti aty dhe e di mirë këtë problem si është. Kjo lëndë mos kujtoni se ka kaluar nëpër dy filtra shumë të mirë dy komitete (komitete përkatëse për pa qenë e kompletuar). I tërë dokumentacioni i nevojshëm është në lëndë, përndryshe nuk do ta kishte pranuar asnjëri komitet. Dikush nuk është mësuar të kryejë punë, kurse dikush dëshiron për të kryer punë. Unë jam për të kryer punë dhe është një pjesë shumë e madhe e Zabelit të "Sahit Agës" e nxënësve të kësaj lagjeje që e kalojnë atë rrugë çdo ditë. Ajo rrugë i nevojitet shkollës dhe nuk i nevojitet dikujt privat, ajo është interes i shkollës. Në të kaluarën kemi kryer kemi këmbyer shumë prona për shkolla si shkolla në Shurdhan, iu kujtohet Xhamia në Derë Mëhallë dhe plotë e plotë këmbime tjera. Unë i kam diku 9 vendime që i kemi kryer në dy vitet e fundit këmbime të pronave. Dhe ne shumë mirë e dimë se nuk mund të bëhet këmbim të pronave për pa pasur Plan rregullues. Mirëpo pa pasur Plan rregullues në atë pjesë është ndërtuar shkolla, pa pasur plan rregullues është ndërtuar rruga, është ndërtuar kanalizimi. Jemi të lumtur që ka ardhur koha për të bërë plan rregullues dhe plani rregullues tash e merr situatën ashtu si është dhe atë situatë e adapton. Nuk do të ketë aso plani rregullues, këtu po garantoj që do ta mbyll atë rrugë.

Ajo rrugë këtu po e them është e shkollës, ajo do të jetë e shkollës. Dikush kërkon që të mbesin problemet për vitin tjetër, por unë nuk jam për t' i lënë problemet për vitin tjetër. Nëse ajo rrugë i ka tri probleme, njërin problem po e zgjidhim sot, kurse problemet tjera i zgjidhim sipas radhës ashtu si të paraqiten. Edhe unë në emër të grupit të LDK-së dhe në emër të atyre nxënësve që kalojnë nëpër atë rrugë unë kërkoj që të votohet ky vendim.

Sadudin Berisha- i nderuari kolegu im i partisë, duhet ta dish se unë jam pikërisht i thirrur për ta bërë një zhvillim shumë të qëndrueshëm në infrastrukturën e Komunës së Gjilanit. Nuk dua të bëhen punë paushalle, siç i ka punuar qeveria e mëparshme. Këmbimi i pronave në zona jo urbane siç janë fshatrat janë diçka tjetër dhe këmbimi pronave për infrastrukturë dhe nevoja publike brenda zonës urbane të qyteti është diçka tjetër. Ne në këtë rast kemi të bëjmë me zonën kadastrale të Gjilanit, dhe jo të Shurdhanit dhe as Përlepnices dhe fshatrave tjera. Edhe nëse i imponon një vendim dhe Urbanizmit ia imponon zgjidhjen urbanistike nuk është ai plan urbanistik. Ai është plan i dhunës dhe i diktatit, por jo plan urbanistik dhe në interes të qytetarëve. Nuk po e kontestoj nevojën për qasje, por po e kontestojmë mos kompletimin e lëndës. Urdhëroni dhe shikoni ortofoton, kërkesa është për shpronësim vetëm për gjysmën e asaj rrugës që shkelet në toka private. Titullari mund të jetë një pronar ashtu siç është thënë, por ai mund të jetë pronar faktik, por jo ligjor. Pronarë ligjor janë të tjerët. Për t' u shpronësuar duhet të gjitha ndërrimet kadastrale të ndodhin e tek pastaj mund të bisedohet kjo çështje.

Kjo kërkesë duhet dërguar në MEF për t' u bërë vlerësimi, se ka bazë së pari për t' u bërë vlerësimi për këmbim, pastaj del vlerësimi financiar i njëres dhe tjetres pronë dhe pastaj lejohet ose të mos lejohet këmbimi. Urdhëroni ju merrni vendime të tilla dhe përgjegjësia

është e juaja dhe kujtoj se nuk po i bënë shërbim të mirë as qytetarëve, kurse më së paku subjektit politik.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që ta aprovojnë pikën 3.8 të rendit të punës, me vërejte të cilat u dhanë plotësim të dokumenteve nëse eventualisht mungon ndonjë dokument.

Aprovohet pika 3.8 e rendit të punës: Propozim vendimin për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për nevojat e rrugës publike –Shkolla e Zabelit, me vërejtjet që u dhanë me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit.

3.9 Kërkesë për përkrahje financiare për tre student të cilët studiojnë jashtë Kosovës

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – kërkesat për tre studentë kanë ardhur në KPF-, kurse njëri është debatuar edhe në Komitet të Arsimit. Mirëpo në mungesë të mjeteve kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe t’i dorëzohet kryetarit të Komitetit për Arsimit për kërkesa, sepse më e drejtë dhe më procedurale është që çdo kërkesë të kalojë nëpër komitetet përkatëse.

Të ndryshme

Arben Mehmeti- e kemi një rekomandim i cili ka ardhur nga Komiteti i Arsimit, por unë i propozoj Kuvendit që ta bartë këtë përgjegjësi te komiteti i Arsimit që t’i hartojë kriteret për regjistrim të nxënësve në klasat e para. Në ditën që Komiteti i Arsimit i harton kriteret për regjistrim të nxënësve në klasat e para, atëherë i kthen në Kuvend për ta marrë vendimin final.

Nazmi Musa – ne në këtë rast kemi bërë shumë zhurmë për asgjë, sepse nuk ka qenë nevoja të debatojmë aq gjatë për imtësi të pa nevojshme. Kjo çështje duhet të bisedohet në kuadër të kompetencave të Drejtorisë së Arsimit dhe kjo çështje nuk ka nevojë të debatohet në Kuvend. Para jush unë e kam një vendim të mëparshëm i cili thotë: “ citohet vendimi..” Unë i zbatoj vendimet, urdhëresat dhe gjithçka tjetër që del nga KK si organ legjislativ. Mirëpo si pedagog dhe menaxher aktual në Drejtorinë e Arsimit dua t’i them disa çështje të cilat janë shumë më të mira dhe përtej mendimit të atyre të cilët nuk kanë punuar në procesin mësimor. Çfarëdo rregullimi dhe përcaktimi i një paralele nëse i kemi dy paralele përsëri do të ketë implikime nga jashtë dhe këtu krijohet problemi me dashje ose pa dashje, bëhet një lloj diskriminimi i fëmijëve tanë, kurse e drejta e fëmijëve është e drejtë e pakontestueshme. Unë po e them se çka është fajtor një fëmijë i një prindi me raste sociale i cili nuk asnjë mundësi për të bërë trysni për të u regjistruar te një mësues “ i mirë”!? Kush i përcaktoi mësuesit e mirë dhe të këqij? Shkolla ka punëtorë dhe jo punëtorë, kurse menaxhimi i shkollës bëhet nga drejtori. Tre faktor duhet të jenë aktual në shkollë, është menaxhimi, mësimdhënia dhe nxënësit.

A mendoni se e tërë fushata që bëhet për NN mësuesin –en se është më i miri! Kush mund ta dijë se cila është ajo performancë e verifikuar se NN mësuesi është një ndër më të mirët në shkollë? Unë iu lus që këto kriteret të ngritën, të bëhen sa më të mira .

Ne do ta kemi një vizitë studimore në Slloveni 6 (gjashtë) komuna për të cilën vizitë është e zgjedhur edhe Komuna e Gjilanit dhe ndër pikat tjera për bashkëpunim dhe për bashkëbisedim është edhe kjo çështje se si bëjnë ata regjistrimin? Përveç tjerash unë për këtë çështje e kam pyetur edhe zonjën Elizabeta nga Cyrihu e që shkollat tona kanë bashkëpunim të përhershëm e të cilën zonjë e kam, pyetur si e bëni ju regjistrimin e nxënësve në klasë të parë. Përgjigja ka qenë; “ prindërit i sjellin nxënësit i regjistrojnë si tërësi dhe i shpërndajmë përmes mënyrave

dhe rregullave të programit të formuar enkas për formimin e paraleleve, ai ndajmë mësuesve paralelet dhe mësuesit njoftohen me nxënësit se unë jam mësuesja e juaj. Nuk ka asnjë kriter tjetër, por është vetëm një komision për ta përcaktuar shkallën e inteligjencës për të u regjistruar në shkollë, por jo për ta dërguar te cili mësues të dëshirojë prindi.

Duhet të jemi të matur dhe të kujdesshëm, sepse ne në Drejtori po ballafaqohemi me raste të tilla dhe raste tjera të cilat kërkojnë kujdes.

Arben Malqi- e tha edhe më herë z. Arbeni, por këtë pikë të rendit të punës fare të mos e sillni këtu, sepse këtë problem ka qenë desh drejtorja për ta zgjedh. Sa i përket formulës e cila është zbatuar deri më tash u pa se ka qenë totalisht e gabuar. Po them e gabuar, sepse kur bëhen disa kritere, ato kritere duhet të jenë ashtu si i ka hije, duhet të jenë të paanshme dhe duhet t' i zbatohet i madh e i vogël, intelektual, jo intelektual, i pasur i varfër. Ka ndodhur që prindërit i kanë regjistruar fëmijët ku ka pasur dëshirë dhe vërtetë ka qenë tmerruese, sepse në vend që fëmija të shkojë me gëzim në shkollë me prindërit e vetë kanë shkuar duke qarë. Kjo ka ndodhur, kjo është skandaloze dhe ky propozim për t' u hequr këto kritere ka qenë dashtë të hiqen më herët para se të ndodhë regjistrimi i fëmijëve. Pasi është bërë regjistrimi i fëmijëve, formula fare nuk ka vlejtur, janë regjistruar fëmijët kush si ka pasur dëshirë! Unë nuk dyshoj fare në aftësitë e drejtorit, sepse ka një përvojë të gjatë, por duhet menduar mirë, sepse arsimit është një mal me probleme, në arsim nuk duhet të bëjmë gabime. Duhet konsultime me grup njerëzish të cilët e njohin lëminë e arsimit. Me fëmijë nuk duhet luajtur dhe mos t' i prishim gëzimin fëmijës. Duhet të kemi kujdes dhe këtë formulë që është praktikuar duhet ta heqim sa më shpejtë, sepse kjo është gabim dhe duhet ta gjejmë një solucion tjetër në mënyrë që fëmijët ditën e parë në shkollë të shkojnë me gëzim dhe jo duke qarë.

Imet Rrahmani – unë nuk jam punëtor i arsimit, por kjo çështje po më duket shqetësuese.

Unë me sa e kuptova nuk është fjala që mos të ketë rregullore për regjistrim të nxënësve në klasë të parë, por është tendenca që ta bëjmë një rregullore tjetër e cila do t' i eliminonte të gjitha këto pakënaqësi që u thanë këtu. Mirëpo pasi ka kaluar regjistrimi për këtë vit, atëherë ka kohë mjaft deri në vitin e ardhshëm shkollor, njerëzit kompetentë të arsimit, duke i shfrytëzuar edhe përvojat e shteteve tjera që u përmenden këtu, të përfshihen në një rregullore e cila do t' i kishte eliminuar ato pakënaqësi që po thuhet se janë skandaloze. Unë e kuptova tendencën që po bëhet fjalë për hartim të një rregullore e cila do t' i kënaq të gjithë.

Nazmi Musa- më duket se po bëhet fjalë se çdo gjë është anarki në procesin mësimor. Nuk është ajo e tërë ajo që po bisedohet edhe pse po bisedohet me një intensitet të nxituar.

Janë vetëm 4 shkolla në të cilat drejtorët kanë bërë ndryshimin e regjistrimit të nxënësve, prej një mësuesi në mësuesin tjetër, prej një klase në klasën tjetër. Nuk është e keqja programi, por është fatkeqësia te intervenuarit e ndryshme. Mirëpo unë e përkrahi mendimin e Arbenit se çfarëdo ndarje të bëhet nëse nuk interferohet nga jashtë më vonë, përsëri do të vijmë tek e njëjta gjendje. Unë i kam një për një për secilin mësues dhe secilën shkollë se kush i ka thyer ato kritere, mandej pse i ka thyer dhe nga kush i ka thyer. Në “Th. Mitko” kemi të bëjmë për 24 ndërrime, prej një klase në klasën tjetër në “Abaz Ajë” i kemi 6 në “Rexhep Elmas” 8 ndërrime, kurse “Selami Hallaçi” i ka dy ndërrime. Kjo ka ndodhur te 40 njerëz, 40 intevenca të 40 prindërve dhe kjo është bërë nga 40 njerëz intelektual dhe mos mendoni se e ka bërë ndonjë i varfër! Për këtë arsyeje shikoni se si luhet me fatin e fëmijëve të varfër, të fortë dhe të dobët. Unë këtu e kam brengën, sepse klasa si klasë të formohet. Ne kemi klasë elite, por kemi edhe klasë që është quajtur elite, por në fakt nuk ka treguar shumë rezultate mësuesi sa kanë treguar prindërit e atyre intelektualëve që kanë punuar dhe punojnë me fëmijët e tyre.

Arben Mehmeti- të mos kuptohet se kjo çështje ka ardhur ad-hok në Kuvend. Pikërisht për shkak të një rëndësie të veçantë të kësaj çështje e kemi sjell në Kuvend, sepse çka do që vije në këtë Kuvend nuk është gabim. KK është organi më i lartë dhe çka do që të nxjerrim këtu është kompetencë e jona. Qëllimi është për ta nxjerr një vendim të ri për këtë çështje dhe Komiteti i Arsimit do t' i sjell disa kritere tjera, kurse ju si anëtarë të Kuvendit do të keni mundësi për të bërë plotësime.

Unë po rekomandoj që komiteti i Arsimit t' i shqyrtojë kriteret për regjistrim dhe pastaj të kthehen në KK.

Sadullah Kadriu- unë i kam shikuar këto kritere aktuale dhe m' u kanë dukur mjaft të paqarta, por drejtori i Arsimit i dha disa sqarime dhe unë me sa po e vërej duhet të harmonizohen qëndrimet. Unë nuk po mund ta marrë me mend pse në "Musa Zajm" nuk ka pasur asnjë lëvizje? Drejtori i Arsimit duhet t' i harmonizojë qëndrimet me drejtorët e shkollave, sepse ata kanë bërë kërkesë për të qenë drejtor të shkollave dhe për këtë arsyeje kanë edhe përgjegjësi. Disa arsimtarë shëtisin rrugëve dhe rrinë nëpër kafe, kurse kur i kërkohet të shkojnë në trajnime ata nuk shkojnë, prandaj pyetje është çfarë masa dhe çka mund të ndërmerret drejtori i Arsimit për këta arsimtarë?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ne po e propozojmë një rekomandim që Komiteti i Arsimit në bashkëpunim me drejtorin e Arsimit të punojnë në përpilimin e kriterëve për regjistrim të nxënësve në klasë të parë e të cilat pastaj do të sillen në Kuvend, kurse Kuvendi do t' i aprovon ato kritere.

Selami Xhemajli- për dashur për ta kaluar rolin e komitetit dhe të Kuvendit si organi më i lartë vendimmarrës në Komunë, unë mendoj se komiteti dhe Kuvendi duhet të jenë edhe në shërbim të ekzekutivit. Në këtë rast drejtori i Arsimit është në rrjedh të problemeve të cilat kanë lindur me rastin e regjistrimit të nxënësve dhe unë mendoj se drejtorja duhet t' i propozoj kriteret e Komitetit për Arsim. Mandej drejtorja duhet t' i propozoj kriteret e komitetit e ato që janë të përbashkëta (të Komitetit të Arsimit dhe DKA-së-) të propozohen, pastaj në Kuvend. Drejtorja është më në rrjedhë, prandaj jo t' i hartojë kriteret komiteti dhe drejtori të pajtohet, por vërejtje dhe sugjerimet të shkojnë përmes drejtorisë në komitet, pastaj sillen në Kuvend.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- unë këtë e thash, t' i rekomandohet Komitetit të Arsimit në bashkëpunim me drejtorin t' i harmonizojnë qëndrimet dhe pastaj këto kritere të sillen në Kuvend në mënyrë që në shtatorin e ardhshëm mos të kemi probleme me regjistrimin e nxënësve.

Në pikën nën të ndryshme është z. Muharrem Bajrami i cili është kryetar i Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës- njësisia në Gjilan i cili ka bërë kërkesë me shkrim për t' i theksuar disa probleme të Shoqatës së Pensionistëve në Gjilan.

Muharrem Bajrami- të nderuar anëtarë të KK-së së Gjilanit po më vjen shumë rëndë që të flasë për atë që më duhet patjetër të flasë sot. Jam duke e përjetuar rëndë shpirtërisht pozitën e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Kosovës Dega në Gjilan. Gjilani i ka 4 mijë pensionistë dhe invalidë të punës e të cilët janë të pakënaqur me Lidhjen e Pensionistëve të Gjilanit e cila për 15 vjet me radhë 7 lokale të pensionistëve i shfrytëzojnë vetëm 3- 4 individ. Për 15 vite ata i kanë harxhuar 215 mijë €. Është fatkeqësi morale dhe kombëtare dhe nuk e kam të qartë pse Qeveria e jonë nuk ka marrë masa deri më tani. Këtë që po e them unë është shumë e vërtetë dhe e saktë. Për çdo të pa vërtetë përgjigjem moralisht, por edhe në çdo

mënyrë tjetër. Ata njerëz i marrin 18 mijë € në vit dhe nga kjo shihet se të jesh pensionist dhe të shfrytëzohen lokalet e pensionistëve është fatkeqësi. Pensionistë bredhin rrugëve të qyteti dhe qëndrojnë në park kur është moti i mirë, kurse kur nuk është moti i mirë nuk kanë strehim. Salla e pensionistëve i ka 170 ulëse dhe deri diku i plotëson kushtet, por 40 ulëse i shfrytëzojnë ata 3-4 njerëz. Nga kjo shihet gjinia femërore (pensionistet) nuk e kanë asnjë kusht për pushim dhe rekreacion. Unë mendoj se ju nuk keni qenë të njoftuar me këtë problem dhe për këtë arsyeje sot gjendem këtu për t' i njoftuar anëtarët e Kuvendit, sepse e keni votën e popullit. Kjo gjendje nuk mund të durohet më kështu, sepse ne kemi kërkuar që shumë vite që këto lokale të jenë në shërbim të dy organizatave në mënyrë që të punohet më së miri. Edhe ish kryetari i mëparshëm dhe kryetari aktual i dinë kontributet tona dhe 150 familje iu kemi dhënë veshmbathje, 150-200 familje iu japim gjëra ushqimore për çdo festë, por edhe në raste të tjera, kurse grupa tjetër asnjë centi nuk e kanë ndarë për kolegët e tyre dhe të gjitha i kanë marrë vetëm për vete. Ju si anëtarë të Kuvendit duhet ta analizoni a bën kështu apo jo? Kërkesa e jonë ka qenë që këto lokale t' i ndajmë për gjysmë. Ne për 15 vjet i kemi harxhuar 15 mijë €, 450 janë të Qeverisë së mëparshme, kurse 2 mijë €, nga kryetari aktual z. Haziri. Sa është e arsyeshme 250 mijë €, me 10 mijë e 500 €. Unë mendoj se këtë çështje ju në një seancë duhet ta debatoni dhe të shikoni se a bënë kështu apo jo? Korrupsioni në këtë shoqatë i ka kaluar të gjitha masat moralo-njerëzore. Shkurtimisht unë i sqarova disa gjëra dhe iu kërkoj falje për kohën të cilën iu mora.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – unë e kam lexuar kërkesën e Sindikatës së Pensionistëve të Gjilanit dhe besoj se kryetari i Komunës do ta formojë një komision i cili do të merret me bashkimin e dy shoqatave të pensionistëve dhe do të zgjidhet problemi në mes tyre, mandej Kuvendi do të merr vendim për ndonjë ndihmë.

Januz Hasani- unë e kam një shqetësim, sepse në një portal ka qenë një shkrim pa pëlqimin tim se gjëja unë tash jam inkuadruar në një grup kuvendar të ashtuquajtur G-5.

I lus mediet që mos të merret me këso dezinformime, sepse askush nuk duhet të jap informatë kundër vullnetit tim. Nuk ka qenë deshtë të figuroj emri i im në atë portal pa pëlqimin tim dhe për pa dhënë unë asnjë informatë. E lus atë portal dhe mediet tjera që mos të japin këso dezinformata! Unë në tërësi e demantoj atë portal dhe kjo është vetëm dezinformuatë.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- pikërisht këtë unë potencova dhe e lus edhe zyrtarin për informim që t' i potencojë këto gjëra, sepse ata që lëshojnë dezinformata të tilla mund edhe të përballen me procese gjyqësore.

Shpresë Kurteshi- sipas disa të dhënave në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në listën e pagave të kësaj drejtorie me kontratë të rregullt të punës figurojnë 33 punëtorë.

Prej 33 punëtorëve, 3 punëtorë kryejnë shërbime në komuna të tjera si bibliotekist në fshatin Pasjan, Budrigë e Ulët dhe në Koretishtë. Me këtë kuptohet se Komuna e Gjilanit është duke i paguar tre punëtorë të cilët punojnë në komuna tjera fqinje.

Mandej Dragan Mlladenović figuron si shërbyer civil në DKRS të Gjilanit, kurse shërbimet i kryen në Artanë (Novo Bërd). Gjithashtu edhe Gjoka Jovanović dhe Janko Jovanović të cilët figurojnë në listën e punëtorëve të DKRS-së, kurse shërbimet i kryejnë në Partesh. E lus drejtorinë e DKRS-së që këto gjëra të merren parasysh dhe të bëhet pastrimi i listave.

Arben Maliqi- unë po e shfrytëzoj rastin për të bërë pyetje, sepse tash ka filluar sezoni vjeshtës dhe gjithmonë ka pasur probleme me sallat e edukatës fizike. Problemi më madh është te Shkolla e Mesme Ekonomike në të cilën sallë, brenda një dite hyjnë dhe ushtrojnë tri

ndërrime. Problemi më i madh është, sepse mungon nxehja qendrore, prandaj për këtë rast duhet marrë masa sa më parë, sepse tash veç fillon edhe sezona e dimrit. Po ashtu kërkesë e imja është që po në këtë shkollë është një pengesë dhe unë kërkoj që urgjentisht ajo pengesë të hiqet. Nuk ka të drejtë që Fakulteti ta uzurpojë atë vend, sepse ai vend është i Shkollës Ekonomike.

Çështje tjetër është që duhet të marrim masa sa më parë përkitazi me trajtimin e qenve endacak, grumbujt e të cilëve po paraqesin problem për qytetarët dhe nxënësit.

Ju lus që sa më parë të merrni masa, sepse ka qenë një rast shumë i rëndë në Komunë të Dardanës, prandaj duhet marrë masa për të mos u përsërit kjo tragjedi.

Mevlyde Zejnullahu- unë po ndërlidhem me diskutimin e Arbenit, sepse edhe unë jam mesimdhënëse në Shkollën e Mesme Ekonomike dhe aty me të vërtetë është një gjendje e rëndë. Shpesh i kam dëgjuar edhe nxënësit kur thonë se ko shkollë është bërë sikur të hyjmë në treg të kafshëve. Nëse ne e presim projektin për rrethimin e kompleksit të shkollave të mesme do të shkojë shumë gjatë, sepse ai projekt për këtë dimër nuk do të realizohet dhe nxënësit do të hyjnë nëpër ujë për të hyrë brenda në shkollë! Kërkojmë që të merren masa dhe ajo rrugë të rregullohet, sepse nuk kërkohen investime të mëdha.

Nazmi Musa- është e vërtetë se Shkolla Ekonomike ka probleme edhe me sallën edhe me oborrin. Është shumë e vërtetë që ajo pjesa e hapësirës nuk pengon vetëm këtë shkollë, por e pengon Gjimnazin, Konviktin, Drejtorinë e Arsimit, sepse është shndërruar në një kantinier ndërtimi dhe është bërë parking i të gjitha veturave dhe kush do dhe kush mbërrin i pari aty parkon veturën. Në fakt aty nuk ka hapësirë lëvizëse për nxënës dhe në fakt duhet të ndërmerret diçka. Ajo që kemi menduar është projekti, rrethojat e shkollës të cilat po vonohen. Një problem tjetër janë salla e edukatës fizike, sepse jemi përtej mundësive për t' i krijuar komoditet organizatave sportive të cilat menjëherë pas procesit mesimor vijjnë dhe kryejnë aktivitetet sportive, prandaj krijohen shpenzime të rrymës, mandej ka shkatërrime të dyshemesë dhe sallës dhe nuk japin asnjë përgjegjësi dhe nuk paguajnë asnjë tatim. Unë apeloj edhe te Komiteti i Arsimit dhe te kuvendarët që të marrim vendim për anulimin apo keqpërdorimin e sallave të edukatës fizike për klubet sportive. Sado që nuk jam kundër klubeve sportive, por ato janë të nxënësve dhe ato po dëmtohen dhe shkatërrohen pa ndonjë përgjegjësi të atyre që po i shkatërrojnë.

Bujar Haziri- unë e falënderoj Shpresën e cila e ngriti këtë çështje, sepse këtë rast e kemi biseduar edhe në Komitet (çështjen e tre zyrtarëve të cilët kryejnë shërbime në komunat e tjera). Kjo është e vërtetë dhe atë që qe disa vite me radhë dhe me siguri prej kohës kur janë bartë kompetencat në komunat e reja. Unë kam kërkuar dhe nga Zyra Ligjore dhe Njësisë Personelit për të parë se a ka ndonjë memorandum për këto çështje, por nuk kam has në asnjë dokument. Unë këtë çështje e kam ngrit në komitet që përmes komitetit, sepse e kemi vërejt se këta punëtorë kryejnë shërbime për komunat e tjera, kurse pagat i marrin nga Komuna e Gjilanit. Unë do t' i vazhdoj konsultimet edhe me drejtoritë e tjera të Komunës për ta shqyrtuar mundësin që të hiqen nga listat e pagave.

Ramiz Ramadani – para se t' i përgjigjem Arbenit e shoh më aktuale çështjen e sëmurje së deleve “Gjuha e kaltër “. Kjo është një sëmurje e deleve e cila është e përhapur në tërë Ballkanin dhe për fat të keq tash është e pranishme edhe në Kosovë, por tash është paraqitur edhe në Gjilan. Rastin e parë e kemi pasur të paraqitur me datë 16 shtator i cili rast më është paraqitur në mëngjes dhe për këtë arsye këtë ditë i kam anuluar të gjitha aktivitetet, sepse nuk ka punë më me prioritet se sa për ta parandaluar përhapjen e kësaj sëmurje.

Kjo sëmurje i bën një dëm të madh blegtorëve dhe me qëllim të reagimit në bazë të kompetencave që i kemi, kam pasur kontakte me Drejtorinë e Shërbimeve të Shëndetit Publik dhe i kam kërkuar kompetencat e drejtorive komunale dhe të Agjensionit të Veterinarisë dhe në aktin e parë e kemi themeluar Komisionin Komunal për menaxhim të kësaj sëmurje, kurse në atë Komision unë jam kryesues si drejtor dhe dy inxhinierë të sektorit të blegtorisë, inspektori i veterinarisë dhe inspektori i shërbimeve publike.

Puna e dytë që e kemi bërë është se kemi fut në lëvizje dhe Agjensionin e Veterinarisë, sepse ka pasur frikë për t' u marrë me këtë problem. E vërteta është mostrat janë dërguar në Angli për analizim dhe sëmurja edhe sot nuk është e konfirmuar zyrtarisht se është "Gjuha e kaltër". Mirëpo pasi që shtrihet në tërë regjionin, mirëpo Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës nuk e ka një dokument që e konfirmon si sëmurje. Mirëpo ne nuk guxojmë ne që të rrimë dhe nuk guxojmë të pres as një javë dhe as dy e tri derisa të kthehen analizat. Mirëpo pasi që ligji lejon dhe bie në kompetencë tonë për ta parandaluar përhapjen e sëmurjes unë së bashku me Komisionin në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike e kemi filluar gruposjen për të gjitha raste e që deri më sot janë 56 krerë dele të gruposura ashtu siç parashihet dhe mendoj se është një menaxhim total komplet. Ajo që e kemi pasur një sfidë të premtën ka qenë që me një vendim të kryeshefit Ekzekutiv të Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinës është se ndalohet lëvizja e deleve në tregje. Është shqetësim shumë i madh për blegtorët, sepse ata tërë vitin kanë punuar për këtë ditë (Kurban Bajram). Tash kërkohet që të gjitha delet të kontrollohen nga mjeku veterinar dhe t' iu epet një kontratë për lëvizje në treg. Këtë të drejtë e ka vetëm Kompania e cila është e autorizuar nga Agjensioni dhe në këtë rast është "Fauna". Mirëpo "Fauna" të premtën nuk kanë qenë të disponuar për të dal për ta marrë atë përgjegjësi, por nga presioni i madh që i kemi bërë të premtën në mbrëmje kanë filluar për të lëshuar certifikata dhe lëshojnë edhe sot. Mirëpo këto certifikata vlefshmërinë e kanë 24 orë, sepse nuk guxojnë për ta marrë përgjegjësinë për një javë, sepse në ndërkohë mund të ndryshojë gjendja.

Të gjithë fermerët (blegtorët) duhet t' i marrin për çdo ditë vërtetimet, sepse për ndryshe nuk i lejohet për të dal në treg. Besoj se kjo sëmurje është në menaxhim të plotë dhe ajo që është e rëndësishme për ta ditur ju nuk bartet te njerëzit dhe nuk bartet prej kafshës në kafshë, por kryesisht këtë sëmurje e bartin mushkonjat. Zonja Rapuca e tha më herë se shkaktar i kësaj sëmurje është për atë se nuk e kemi bërë dezinfektimin, por kjo sëmurje është përhap në tërë Ballkanin dhe nëse të gjithë e kanë këtë problem, është e pamundshme të jetë faktori mushkonja për përhapje të kësaj sëmurje.

Te çështja e trajtimit të qenve të cilën e ngriti Arbeni është fakt se në tërë Kosovën janë tri Komuna të cilat i trajtojnë qentë dhe është e palogjikshme ne Gjilani t' i trajtojmë kur Vitia nuk i trajton, po ashtu edhe Dardana dhe Artana., sepse ky është terren i ngushtë dhe ata lëvizin. Deri më tash po ia them me përgjegjësi mbi 300 qenë i kemi dërguar në Nagavc. Mirëpo është punë e kotë, sepse menjëherë vijnë të tjerët nga komunat që i përmenda. Ky trajtim duhet të bëhet në nivel të Kosovës. Ju kërktoj falje për atë që e zgjata.

Imet Rrahmani- unë po i ngris dy çështje të cilat i kam ngritur më herë dhe më nuk do t' i përmendi asnjëherë. Janë dy çështje të cilat nuk kanë implikime buxhetore. Së pari respektimi Ligjit anti duhan, sepse është sezona e dimrit i cili nuk po respektohet fare dhe deri më tash nuk iu është ofruar klientëve tak e tuke, kurse ta edhe po iu servohet në tavolinë. Ky ligj nuk është duke u respektuar në tërë Kosovën, por në emergjencë ku punoj unë ky ligj respektohet. Kërkoj që të mos bëhet dukuri kjo çështje aty ku ne jemi kompetent. Unë e falënderoj drejtorin Xhelili të cilën kur e kam thirrur është angazhuar menjëherë, por janë disa kompetenca të cilat nuk po varen prej tij.

E dyta është se diku në fillim të sezonit të verës këtu në Kuvend e kam thënë se duhet respektuar Rregulloren e KK-së për orarin e punës të kompanive të ndryshme, gjatë vikendit dhe gjatë festave. Nuk është kjo kërkesë personale, sepse mua si person më konvenon orari i punës në çdo kohë, por është një kërkesë e një numrit të madh të punësuarve edhe të kompanive të vogla. Është e pakuptimtë punëtorët të punojnë deri në ora 24 dhe mos të dihet kur është ditë vikendi dhe kur është ditë festë. Nëse rregullorja e cila është në fuqi ne duhet ta fillojmë procedurën për ta plotësuar dhe ndryshuar. Unë kam bërë një kërkesë më herët për këtë çështje, por përgjigja ka qenë që është vullneti i kryetarit që të vazhdohet në sezon të verës dhe sezona e verës ka përfunduar dhe mërgimtarët tanë janë kthyer dhe tash nuk kemi arsyeje të mos e respektojmë këtë rregullore.

Ismail Jonuzi- për shkak të informimit atë që nuk e tha drejtori Ramizi është se kemi pasur ftesë për ta vizituar panairin ndërkombëtar në Tiranë, por drejtori ka heq dorë, sepse i ka kushtuar rëndësi përhapjes së sëmurjes së deleve në Komunën tonë.

Me këto debate dhe vendime seanca e dhjetë i përfundoi punimet në ora 15.30 min

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi